

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS  
SEKSIONI I GJUHËSISË DHE I LETËRSISË

Ali Podrimja

# VEPRA

VËLLIMI I PESTË



PRISHTINË, 2013

KOSOVA ACADEMY OF SCIENCES AND ARTS  
SECTION OF LITERATURE AND LINGUISTICS

Ali Podrimja

# WORKS

V

Editorial board:

Ali Aliu, editor  
Rexhep Ismajli  
Eqrem Basha  
Sabri Hamiti  
Mehmet Kraja



PRISHTINË, 2013

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS  
SEKSIONI I GJUHËSISË DHE I LETËRSISË

Ali Podrimja

# VEPRA

VËLLIMI I PESTË

Redaksia:

Ali Aliu, redaktor përgjegjës  
Rexhep Ismajli  
Eqrem Basha  
Sabri Hamiti  
Mehmet Kraja



PRISHTINË, 2013







# **NË BISHT TË SORRËS**

Art-Pena, Prishtinë, 1994





## VONË ÇEL DITA

### LOJA ME VDEKJEN

Nuk di sa vjet u bënë  
por unë u mësova më në fund  
edhe me minj e gjarpërinj e engjuj

Bi e çohem  
me nga një therrë të re  
në këmbë të majtë

E rreth qafës sime të hollë  
vazhdon të trashet  
vezullima e tmerrshme e Thikës

Nuk më mashtrojnë më  
as fjalët e urithit dhëmbëkali  
në vesh që m'i pëshpërit

E shoh  
Mall e kam  
edhe këmishën e arnuar të Nënës

Tani për tani vetëm di  
se jetoj në mënyrë krejtësisht normale  
dhe me vdekjen luaj si me kokë maceje

## NOKTURNO

Kur bishtat shumohen  
rrallohen kokët  
Dhëmbë të verdhë vetëtijnë

E në Derë  
tek sa nuk ka trokitur  
e paPritura

Kur kokët rrokullisen  
deri në fyt  
nata mbushet me bishta

E fjalët zënë n'thu

## NË PLANETIN E HUMBUR

Pas grilave  
koha shpuzë cigareje  
Me akull  
ma lajnë kokën  
dhe nga zorra dymbëdhjetëgjishtore  
ma nxjerrin  
edhe copën e fundit të mutit  
        pastrim total a  
Por zoti ka shumë sy  
e më gjen diku  
në Planetin e Humbur  
Kur të kalojë edhe kohë e kungujve  
Mollën në degë ndoshta  
e këput edhe unë  
Ndoshta

## KRIMINELI NË FOTO

Nga një Kopsht Zoologjik  
një kafshë e zakonshme për kohë tona  
rastësisht e veshur  
me lëkurën më të lirë të njeriut  
u buzëqesh viktimave  
në kalim

A nuk e vëreni  
edhe krahun e fëmijës  
në foto të pazakonshme  
si e mbulon gjaku i padukshëm  
nga thonjtë e tij të mprehtë  
imixh  
i një mesazhi të tmerrshëm njerëzor

## MIU I SHKURREVE

Nuk e hetova  
Mi i zakonshëm ishte  
Edhe një mace e coftë  
do ta nxirrte jashtë  
Po mace as qen kisha  
Isha një bujar me nam  
që nuk i zbritja kalit  
as dorë merrja zotërave  
’i pikë ujë pija në Krue  
kur ma trupoi udhën  
Ciat e bren e shkretëron  
Shumohet hatashëm mijnçe më  
Brenda e jashtë shtëpisë  
tërmete e zjarre e ulërimë  
Gjysma e rrashtës  
tejtëj Hudutit  
në gjumë mortjeje gjysma  
Ndonjë endacak perëndi  
përbirohet nëpër klithma  
Dridhen bjeshkët terrohen fushat  
Në shkurre kundërmon oxhak i vjetër  
Miu na u bë Zot  
Edhe vdekja pak

## MOLLA E KUQE

Kur ra Toplica  
në Kosovë u zgjova

Ndeza pishën  
fytyrën t'ia shoh Nënës

Nga Planeti i Humbur ajo  
ma hodhi 'i Mollë të Kuqe

E më tha: Mos më harro

'i qind vjet po i lë

E te koka ime  
Molla kuqëlohet edhe më

Ç'popull jemi

## NË MESNATË

*Në dritare ra një zog i zi*

*E më tha: Mos shko! Të pret Djalli!*

(Fragment i harruar nga Stina e Armëve)

Në orën dymbëdhjetë në mesnatë  
në gjunjë do të biesh  
të fshijsh në Pasqyrë  
Pikën e Zezë

Dhe në mes xhenazeve  
nuk do ta pranosh kurrë  
se gjakun ta kanë pirë  
me pambuk njerëzit e akullt

Në orën dymbëdhjetë në mesnatë  
Po nuk këndove  
do të çelë zogj  
Qyqja

Dhe Hënën do të kërkojnë  
në fund të Pusit hienat

## VAJTOJCAT E REKËS

*Josif Bagerit*

Kur vjen e diela  
oh kur vjen e diela  
në të zeza vishet Reka

Gozhdave varrin  
Gjuhën e Dhunës  
dhe Zotin e huaj

Nga Mali i Thatë  
në Malin e Shenjtë  
fluturon Qyqja

Kur vjen e diela  
oh kur vjen e diela  
e diela kur vjen moreee

Vajtojcet e Rekës  
zbresin te varret  
e qajnë shqip

*Gostivar, 17.2.1993*



## SORRAT

Mbi çati  
cokëllojnë  
sorrat

Kaçep i padukshëm  
thyen  
Vezën e Sorranisë

Në shuplakën time  
ç'zog  
bie

Zgjothem apo

Në xhep të këmishës  
Gjarpri  
lule e verdhë

Sorrat hije xhindësh

## PSE MË VRITNI ZOTËRI

*Edhe një ushtar shqiptar  
u vra “tragjikisht”*

Ndanë Udhe

Ndanë Kroit

Ndanë Librit

Më vritni zotëri

Duke Ëndërruar

Duke Udhëtuar

Duke Dashuruar

Më vritni zotëri

Në Arkë

Në Varr

Në Kujtesë

A ma kyçni edhe buzëqeshjen

Zotëri

Pse më vritni

Fundi është zgjimi im

NJERIU QË PËRSHKROI RËNIEN E  
DIKTATURËS PA THËNË NJË FJALË

Ai e dinte se do të dilte fitues  
Shpirti i tij  
bridhte jashtë mureve  
Lakuriq zhvishej  
i palonte teshat këpucët brushën e dhëmbëve  
të rrojës

Shtrihej në qivur  
aty në midis të birucës  
Polic i me automatik  
e mbështillte me qefin  
nga maja e gishtërinjve te goja  
Disa herë rrotullonte çelësat në bravë pastaj  
Minjtë e uritur i lëshonte nga kafazi  
Ai e dinte se do të dilte fitues  
frushkujt e dritës i shikonte  
si përbiroheshin përmes vrimës  
prej nga Polici me automatik përcillte  
lojën e minjve të uritur  
rreth qivurit  
ku frymonte Njeriu që besonte  
se do të kalojë edhe kjo mutsihane

Dhe përnatë dhe përditë  
po ai ceremonial lëvizjesh  
po ai qivur  
dhe po ata minj  
të cilët në mëngjes  
i mbyllte në kafaz Polici me automatik  
dhe e zgjonte njeriun nga ëndrrat  
shpirti i të cilit bridhte jashtë mureve

Ai pastronte dhëmbët fytyrën  
Nga flokët e verdhë shkundte terrin  
me gishtërinj të shkurtuar  
ua shkrepse nga një vetëtimë  
minjve në kafaz  
dhe Policin me automatik

Vite e vite kishin kaluar  
e vërshimë e thatësira shfaqur në Sorrani  
Njeriu që kishte harruar trupin  
brenda mureve të larta  
Shpirtin të shndërruar në trëndafil  
E hidhte një pasdite me shi  
në qivurin e zbrazët  
që e shpienin diku  
në Varre të Gjata

## GJAKU I ZI

Kafshën e ka zënë Gjaku  
Gjaku na paska zënë bre  
Kafshën

Po brisku more na ra në Dri  
e Vala  
ku e qiti

Si t'i bëhet memecllëkut  
kur edhe Dheun  
na mori ngryk mortja

Pa cofur Gomari  
s'e shohim  
Majën e Pashtrikut

ZGJIMI I KOBSHËM  
I XHUXHIMAXHUXHIT

Mbasi ia kishte këputur gjethet  
pastaj rrembat  
dhe degët  
Dhe mbasi ia kishte trembur edhe zogjtë  
kishte zbritur  
t'ia kërkonte edhe rrënjët e shpërndara  
në dhe thellë  
Majë e tij më tmerron  
    m'i fsheh Diell e Qiell  
Rreth trupit të hapur  
këlthiste xhuxhmaxhuxhi  
E Bukuri e Cungut  
    pas shumë e shumë vjetësh  
    në këmbë ngritur kishte  
    një mbretëri butakësh  
    atje poshtë poshtë     p  
                                   o  
                                   sh  
                                   t  
                                   ë

## MEDITIM PËR ZOTIN

Mirë që imzot  
është i bardhë  
dhe e shoh  
edhe në ëndërr

I zi të ishte  
do të harroja  
se kam pasur perëndi  
e atdhe ndonjëherë

Mirë që tim zoti  
lëkura i ndrit  
e nuk më frikëson  
as kur floku i skuqet

'i herë ndoshta zbardh  
edhe fqinji të ketë  
një zot të bardhë  
e kopenë në vathë

Po tim zot atëherë  
mes mumieve si ta dalloj  
apo edhe më në shpinë  
rrasën e varrit të bart unë

## MOS ËSHTE NJERIU

Ç'ulërin

Del nëna  
Dheut i vë veshin  
Del babai  
mbështillet shtrëngatës  
Del vëllai  
Malit i qepet  
Del motra  
vishet në të bardha

Në të bardha  
të dashurit e mi  
në të bardha unë  
Nuk shihemi  
as dëgjohemi më  
e Lugut e Kodrës  
lëkurën lë  
Drini

Dhe ulërin ulërin  
Mos është  
Njeriu



## NË KALVAR

Të lindja në Prizren  
një Gjergj Elez Ali më pak  
Mbi mua nuk do të shembeshin qiejt

Në Vlorë të lindja  
nga sytë e mi të shqetësuar  
dy dete do të vërshonin Fushë-Pikëllimën

Po linda në Gjakovë  
Në thes ia bart kokën  
Kalvarit tim

Oh Nënë  
si nuk më zgjove  
para se të ulërinin ujçit

## VONË ÇEL DITA

Ndodhi e kokët  
lulan  
mezhdave

Është shenjë  
se vonë çel  
dita

Po ndodhi  
e Loza  
mbështolli ATdheun

Te Pusi Hëna  
ndërron rrobat  
se kushedi kur çel dita

## UJI I MADH VJEN

### SHIKIMI NGA DRITARJA\*)

Asnjë pikë loti  
Ne shkuam apo  
Vetëm këndonani  
Lirinë e përjetuam  
edhe nga brenda

*27.5.1993, Prishtinë*

---

\* Kjo dhe tri poezitë vijuese janë disa prej shkrimeve nga ditët e grevës së njohur të gazetarëve të “Rilindjes” të mbajtur në vitin 1993

## LETËR PETRITIT

Kurrë më i fortë  
e më i qetë  
nuk e kam pritur vdekjen

dhe nëpër ëndrra  
nuk të kam kërkuar  
kurrë më shumë vogëlushi im

Në mes mureve të larta  
hap qiellin nuri im  
dhe gjak i marr Kafshës në vesh

Por por  
Liria si na duket  
çfarë sysh ka  
e ç'fustan vesh  
të shkurtër apo të gjatë

Në dritare të pikëlluar  
xhami i shurdhët  
dhe flatrat e engjëllit të shiut

*28.5.1993, Prishtinë*

## LAMENT PËR LIRINË E NJERIUT

Falënderoj  
Evropën Demokratike  
aparteidin Kosova që krijoi

Kohë të mos humbasë  
deri në Afrikë  
instinkt i neveritshëm njerëzor

Falënderoj popullin e qeverinë serbe  
që ma mëson  
gjuhën e hazardëve

Dhe gjumë të rehatshëm i uroj popullit tim  
që më bëri të vuaj  
për Lirinë e Njeriut

*29.5.1993, Prishtinë*

## KËLTHITJE NË SHKRETËTIRË

Ika nga liria  
Me të nuk desha  
të grindem më  
Ishte e tmerrshme

Në Kullë të lartë  
të “Rilindjes”  
u ngujova por as brenda  
të qetë nuk më lë ajo

Shoh se jam  
vetëm  
një këlthitje  
në shkretëtirë

*1.6.1993, Prishtinë*

## LIRIA ËSHTË E TMERRSHME

Liria është e tmerrshme

Nuk më flihet  
se nuk më zgjohet

Nuk më rrihet  
se nuk më lëvizet

Nuk më jetohe  
se nuk më vdiset

Liria është e tmerrshme

Të tërheq për litar  
e qen bre a je

Mureve ta thyen kokën  
e gëzohesh

Sapo t'ia zbulosh  
trupin e luluar

Liria është e tmerrshme

Ora ime bie  
Të loz a do të di

Tmerri im është ajo



## UJI I MADH VJEN

Thuajmë diçka miku im  
Thuajmë se prapë  
do të shoh Lumin p.sh.  
me një trëndafil në dorë

Thuajmë miku im  
se do të kemi gjithçka  
dhe Lirinë do ta lidhim fort  
për rrënjë rrapi

Thuajmë miku im  
qershitë janë sytë  
e fëmijëve tanë  
të helmuar

Thuajmë miku im  
na polli kudra  
e cofi  
Vdekja

Hajt ta pafsha hajrin  
Ujë i Madh  
vjen  
e harron çdo gjë

*Prishtinë, korrik, 1990*

## DHOMA E BARDHË SUEDEZE

Anija Vlora  
lëviz ngadalë në ekran  
dhe refugjatët  
perëndi a hije Dodone

Këmbë e kalonin detin  
dikur arbëreshët e mi  
e s'i priste asnjë polic me shufra gome

Në ekran vazhdon udhëtimi vdekatar  
dhe anija Vlora të tundet  
nga mllafi i perëndive zemërake

Në shkretëtirën e bardhë suedeze  
diku mbi harkun ditor  
shfaqet një pikë e zezë

More a jemi prej gjakut

Në Kosovë na vrasin  
Iket nga Shqipëria  
Në Çamëri s'na i dinë varret

Mos frymuakemi për shkak të epeve të orëve

Mbyll sytë  
Më ngulfat qetësia polare  
në dhomën e bardhë suedeze

*Suedi, gusht, 1991*

## NË EKSPOZITË QENSH

Ika nga qentë  
dhe në ekspozitë qensh hyra  
Eh Evropë  
holl po tjerr

*Feldafing, 15.4.1992*

## MIDIS XHUNGLËS SË BETONIT

As djalë as vajzë

Një mace kishin  
ose një qen

Në sy të tyre të xhamtë  
fotografonin vdekjen

tinëzisht që i hante  
midis xhunglës së betonit

*Feldafing, 22.4.1992*

**PËRSE NUK MUND  
T'I MBYLL SYTË**

**MAGJIA E KOSOVËS**

Dorë e të zotit  
në degë e vjel  
ose rreth Gardhit  
lidh Qenin e Sharrit

## GJARPRI OH GJARPRI

Sytë me të mbetë

Po Gjarpri  
po Gjarpri Nëno  
ma zuri Derën

Nën Urën e Shenjtë  
dritat e ballit  
në gjinj m'i mori Drini

E vdekja oh Vdekja  
zgjat gjuhën  
mbi zjarrin tim

Digjet apo bëhem varr

ATDHEU ËSHTË DHEMBJE

E pas Kosovës  
me siguri Saharaja në shpirt  
se Atdheu  
është dhembje

*Schwalenberg, 15.X.1993*



## LIRIA E TEPËRT

*Ernit*

Po të pikojë gjak  
është ajo  
e egra

e tmerrshmja

Por  
liria e tepërt  
ta ha kokën

*Frankfurt, 2.X.1993*

## FYSHTI I FISIT

Mali i lartë e i frikshëm  
po syri i tij i gjithëfuqishëm  
hatashëm lëvizte  
duke kërkuar misterin e së paqenës  
Dhe e kishte për zakon  
ndonjë mik kur përcillte në varre  
në gju ulte një fëmijë  
aty tek çerdhja “Lumturia jonë”  
dhe me buzëqeshje të gastartë  
ndriste Majën e Malit të frikshëm  
Nga Vilë e Shpirtrave te Fortesë e Qyqeve  
fillonte e mbaronte  
atdheu i shkretë  
Tej Gurit të Përgjakur  
nuk ekzistonin Ilirë as Iliri  
Armiq të tij ishin ata  
Edhe në gjumë  
kokët ua shkurtonte trimi ynë  
Fyshti i Fisit

BALADË PËR LETRAKUN  
DHE ATDHEUN

Mjerë ai popull  
letrakun që shpall  
Moisi kombi  
e qet në fëmijë

Pas bjeshkëve deteve  
mjerë ai popull  
fatin që kërkon  
e atdheun e lidh  
për qafe lejleku

Imzot o zotynë  
ç'mund të pritët  
nga grigja e shthurur  
i marri kur i prin

## NGJITJA NË MAJËN E TOMORRIT

Nuk na u nda një shqiponjë  
Udhë e Abazalisë udhë e lartësive

Tërë frymë e të papritura o i uruar  
Sa harrova Lumin dhe Kosovën

Vështirë qenka të jesh perëndi  
T'i shikosh njerëzit nga Maja

*Uji i Zi, Tomorr, 1993*

## ALETË E KORÇËS

Aleve të pafund të Korçës  
si aleve të harruara të Ilirisë  
ç'm'u shfaq harta e humbjeve të mia

Vaji i thekshëm i një flaute të vetmuar  
aty në hijen e Orakullit të Dodonës  
thyen heshtjen e çatave mijëvjeçare

E në shuplakën e shtrirë të territ  
pikëlonin yje  
nga qiejt e padukshëm

Yje Kosove  
as Çamërie  
nuk ishin ata

Po klithma të një flaute trishtuese  
që më zgjonte aleve të Korçës  
mbi hartën e humbjeve të mia

Mbi ballin tim flakë  
flad i Ohrisë  
dorë perëndie

A e gjeta udhën për në Iliri Nëno

*Korçë, 1993*

## DINOZAURËT

Në Janinën e Frashërenjve  
qiellit zbresin  
perënditë e metropoleve

Te Ura e Artës  
Marko Boçar Suliotin  
ç'na e zgjon 'i ëndërr

Në katër shtiza  
të katër kalorësve mavi  
kokë e Ali Pashait  
del Dheut

Në Janinën e Frashërenjve  
Lis i Konicajve  
britmat mbyt me shushurimë

E në Dodonë sezoni dimëror  
mbyllet me shfaqjen  
Dinozaurët nuk kanë ç'të hanë më

## SERBISTANI

Përditë e përvjet  
në sallone akustikettransparente  
veshur me pasqyra të zeza  
në mënyrën më gjeniale  
pa kurrëfarë dhembjeje e dridhjeje dore  
transplantohen gjymtyrë  
të të gjitha moshave e gjinive  
Dhe në konferenca ndërKombëtare  
në simpoziume nacionalfashistoliberale  
ku sheshopingsatanarkshelët  
reklamojnë modën më të re  
Torzo Made in Bosnia 2013  
nuk prajnë çakejtë:  
Pakica shqiptare  
i gëzon të gjitha të drejtat  
edhe të drejtën për vetasimilim  
Po ne që jemi Popull  
dhe metropoleve të Evropës  
me vjet që lexojmë  
skizofreninë serbe si aksident njerëzor  
dimë se nuk janë gjethe ulliri  
Krokama Shpella Varri

Në zemër të Dheut prandaj kyçemi  
përditë e përvjet  
qiejt e fëmijëve tanë  
t'i mbrojmë nga çakejtë



## ME QENË

Të jesh shqiptar  
e vdekja të mos të gjejë  
edhe në skaj të botës  
e pamundur është

Të jesh shqiptar  
e ndonjë qen të mos të ndjek  
deri në varr  
e pamundur është

Shqiptar të jesh  
botën varr të mos e kesh  
e pamundur është  
e pamundur

Në trupin tim  
plaga më e thellë  
sa më afër  
Bregut

## NË MBARIM TË SHEKULLIT

Në midis të Evropës  
Në midis të midisit  
Në hotelin Marriot të Frankfurtit  
ku asgjë nuk mungon  
dhe ku veten sheh në të gjitha pasqyrat  
shkruan poezi për lirinë  
i bindur për të satën herë  
se në jetë megjithatë  
diçka po munguaka  
Natën e mirë Kosovë  
Vdekja vazhdon të këndojë në Sarajevë  
dhe kokë të prera njerëzish  
t'i vijne peshqesh Evropës së fjetur

*2.X.1992, Frankfurt*

## NË MES BUTAKËVE

Lumi unë  
hap e mbyll ditën  
me një flutur të zezë

Nuk i besoja gjyshit  
as babait  
Por ç'porosi t'i lë Petritit

Në mes butakëve  
e mutakëve  
digjem

Duke iu afruar Fundit

## SHIKOJE TERRIN

Nuk të dëgjuan  
Dëgjoje në kodër vajin e erës

Nuk të panë  
Shikoje në xham fytyrën e territ  
si përgjaket

Po të shanë  
Mos e përlyej fjalën

Pas fitores në Termopile  
Me çka ta lajmërosh Nënë

PËRSE NUK MUND T'I MBYLL SYTË

Vetëtinë  
edhe në poezi

Hënë e plotë  
kurrë fytyra ime

Ja përse  
nuk mund t'i mbyll sytë

*1990*

## NË BISHT TË SORRËS

### FLETA E MBRAMË E LIBRIT

Buzëqeshja në kafaz  
mbahet mend më gjatë  
se buzëqeshja e zakonshme

Në të gjitha gjuhët *Jetë*  
do të thotë *Lufjë*  
që askush nuk e ka fituar

Pasi të shuhet edhe Qiriri  
përpiquni të harroni  
muzgun e mbramë

Ose kalojeni  
edhe njëherë  
Detin e Vdekur

Do të dukeni më seriozë  
para se t'u shkulin  
nga Dheu

*Schwalenberg, 29.X.1993*

## MBYLLJA E RRETHIT

Udhën ua kallëzova  
Burrëria te Vija e Zjarrit  
Nuk i dolët në krye  
Mbani mend fërkemet e dhisë  
    Nata e gjatë  
    e korbat  
    të bardhë

## NË BISHT TË SORRËS

as Dry as Çelës  
Myshk e Ndryshk

Tokë e Qiell  
pa Hënë e Diell

Piku Molla  
të ëndrrës formën ka

Gjak e Thikë  
nuk ndrisin vetëm  
në Kasaphane

'i Bajloz ka dalë  
e na gurëzon kopenë

Lum e lum  
për Gjergj Elez Alinë

*1990*



# **BUZËQESHJE NË KAFAZ**

Dukagjini, Prishtinë, 1995



## NË NJË BODRUM TË SHEKULLIT NJËZET

Diku në katin e mesëm fqinji im sa më shoh hap  
derën dhe nis ta pastrojë armën e ftohtë E fshin  
dhe buzëqesh me një zë të veçantë që më së paku i  
ngjan gazit të njeriut Kështu vepron gati çdo ditë  
por unë e di kush ia ka dhënë atë armë vdekjeprurëse

dhe në cilën çetë vrasësh do të rreshtohet  
Vetëm nuk di a e di i gjori se edhe unë kam të drejtë  
të jetoj Shkruaj këtë tekst të dëshmoj se unë  
rroj në një vend me emrin Kosova ku fëmijët as të  
rriturit nuk dinë kur janë Kërshëndellat Viti i Ri  
apo ndonjë festë kombëtare

Në kokërr të shpinës shkruaj dhe lexoj yjet para  
se të fiken në një bodrum të shekullit të njëzet kur  
po merr fund edhe bashkimi i Evropës së dresuar  
Ndoshta më mirë është të veproj kështu se sa të  
zbres në mes të gogolëve të cilët kanë zënë t'ia  
djegin bishtin Evropës

Oh Evropë  
si po dukesh  
pa bisht

*29.12.1991, Prishtinë*

## KËTU NË FUND TË BOTËS

### RELIKE TË FUNDSHEKULLIT

Kur dhuna  
bëhet ligj  
liria është afër

Njerëzit rrinë zgjuar  
Natë as ditë  
s'tregon ora

Rreth qafe me gishtërinj e vesh  
e sy fëmijësh  
hijet shndërrohen  
në varr të gjallë

Liria s'është larg  
kur ligji  
bëhet dhunë

## NË HIJEN E ZOTIT TË PADUKSHËM

E ku sytë e Argusit

Pas territ  
Nënat fshehin cullakun  
e fëmijët thithin gishtërinjtë

Zoti i padukshëm  
një nga një fik ëndrrat  
dhe lutet për mëkatet e Djallit  
E ti ha e pi e jeton  
nga xhepi im i shqyer  
Ma shkund pemën në Oborr

Mbi pullaz të kërrusur përshëndetet Dielli  
me hijen time të shkurtuar  
dhe Djalli ma fsheh në Kuti të Zezë

E ku sytë e Argusit

Pa frikë se e godas ma pret udhën Dhelpira  
Bie në gjunjë  
dhe e kafshoj trishtimin në ballë

Në hijen e zotit të padukshëm

## PROMOVIMI I SATANËS

Gjithsesi të trillohet një ebre i verdhë  
një popull ebre  
pa atdhe

Ndryshe nuk mund të ndërrohet asgjë  
as të bluajë Rrota e Hekurt

Të ngrihet pastaj një fabrikë  
aman vetëm një fabrikë  
për ëndrra të larme  
tevana një Gullag dhe  
varri i madh i elefantëve të Afrikës

Ndryshe nuk mund të arrijë paqja në shpirtin tuaj  
as të përjetohet Simfonia e nëntë e Bethovenit  
ekzekutuar nga Çerdhja e fëmijëve  
Gjejeni patjetër një vrasës një fajtor  
rrënues tempujsh varrezash  
një rrebel trashaman  
dhunues anadollak

Dhe e paqenja të niset nga lagja e varfanjakëve

Ndryshe nuk mund të ndërrohet asgjë  
as të promovohet Lartmadhëria e tij  
me fytyrë prej ëngjëlli  
me dhëmbë prej gjarpri

Po ku të gjendet ai ebre i verdhë  
ai popull endacak  
ai varr i madh elefantësh  
ajo fabrikë për ëndrra të larme

Ku të gjendet ai vrasës ai fajtor  
ai rebel ai dhunues  
kur asgjë më nuk frymon  
ai pidhi i maces.

## QYTETARI I APARTEIDIT

Ai aspak nuk ngutet  
është i durueshëm  
dhe i sigurt në ëndrrën e vet

E di ku e ka vendin dhe ç'mendon Satana

Ai kurrë s'ka qenë ai që duhet të jetë

Është ekzemplar i klasit të parë  
I shkolluar i qytetëruar i përdorshëm  
por tepriçë teknologjike

Ai nuk ka vend të caktuar  
E gjen ku nuk mendon as zoti

Është ylli i mbramë i Evropës  
megjithëse i papushtueshëm i pambrojtur  
nga Ligji e Perëndia

Me fishkëllimë pikëlluese  
zotëria e tij na shqetëson shpesh  
edhe në pikë të natës



Ai nuk ka masë  
hundët i ka të tymosura  
sytë plot lotsjellës

Nga dita në ditë jeton me një kore buke  
me një kokërr kripe  
me një fletë qepë

Dhe kur del nga shtëpia  
grua e fëmijë  
i puth në sy

Ai është viktimë e sistemit

Ai është maestro i muzgjeve i agimeve të largëta  
Nën çatinë e thyer rri dhe e dëgjoj deri vonë violinën e tij

dhe kam besim

edhe kur e shoh me duar në xhepa Evropës  
edhe kur vesh hijen e vdekjes  
edhe kur na lë lamtumirën

Ai është fundi i sistemit

## SATANA I SOKAQEVE TË MIA

Përditë e takoj Satanën e sokaqeve të mia  
në sheshe në uzina në shkolla në biblioteka  
Gjurmët m’i nuhat ma ngreh kurthën lakun  
Me zindane më kërcënohet me topuz  
me uri me gjak

Po një popull a mund të zhduket me farë  
kur tërë jetën udhëton kah ylli i vet polar  
E shoh nën dritën e hënës duke më shpalosur  
M’i hap librat ngarend poezive kryeneçe  
humb në labirithin e shpirtit të dashurisë  
një nga një fjalët m’i var

Ma vë kokën në cung ma nxjerr trurin me pincetë  
Therr qelizat me gjilpëra Ngjitet lart trungut tim  
e bie shtatë pashë thellë në tokën e gjakosur pastaj  
heq thikën e ndryshkët nga kllefi i qëndisur  
Ma kërkon fuqinë burimin ma kërkon rrënjën e moçme  
dhe bishtcubel ik pasmesnate në qymezin e vet  
Kushedi se kur e takoj në shëtitje në nevojtoje  
Këngë vaj m’i kop gjurmë të mos më mbesë  
Më zgërdhiet se do të më fshijë nga dheu  
Në birë të minit do të më kyçë shtatë herë  
Çka nuk më të thotë o zot Satana i sokaqeve të mia

Shkumbë e bardhë ia mbulon turinjtë fytyrën  
Hije gjaku iu bie syve të çartalluar  
Dhe derisa pi kafën e mëngjesit në “Elidë”  
një fëmijë fshin *b... me fotografinë e tij*  
e nëpër xhamin e turbullt shoh të gjorin  
si vete në gjueti për miza duke i rënë tupanit të pëlçitur

## EVROPA PËRMES GRILAVE

*Ludwig Hartingerit*

Në dhomën akustike hyn Evropa përmes grilave

dhe më del ëndrra

Pëshpëris vitet: 1878, 1913, 1924, 1945

Kujtoj Mollën e Kuqe<sup>1</sup>

hingëllimën e vrançit

kur shurdhonte Toplicë e Artë

Ja erdhi edhe viti 1992

Kongreset e anktheve e pabesive

Po unë ende marr frymë

Mas hijen me pëllëmbë rrjepacake

deri në skaj të horizontit

A kam më kohë për korrigjime

Larg atje shoqërohesh miku im

me tingujt e Mocartit

letrat m'i nis që kurrë s'arrijnë

---

<sup>1</sup> Molla e Kuqe, kufiri i dikurshëm në mes shqiptarëve dhe serbëve

E asht e lëkurë zbres unë  
në rrethin e Nëntë të Ferrit  
Tjerr terrin verbues  
Mësoj veshin me vetminë e fjalëve e shkronjave  
me shushurimën e ujërave  
dhe shpirtrave të fikur  
Këtu çdo gjë miku im paguhet më kokë  
edhe ninulla për carrokë

Shoh Evropën përmes grilave duke shpaluar trupin  
në breg të erërave

Mos lypset ta kafshoj në dy faqet kuqaloshë  
Nën lëkurën e djegur ta fsheh pushin e saj  
nga era e verdhë

Forma kentauresh po qe se marrin grilat  
gjak i ri i duhet Evropës miku im  
dhe një zot kokëfortë

## DELIRIUM

Një kokë serbe  
dhjetë koka shqiptare  
Pak Vojvodë<sup>2)</sup>

Një kokë serbe  
njëqind koka shqiptare  
Shumë pak Vojvodë

Një kokë serbe  
një mijë koka shqiptare  
Si asnjë për Qele Kullë Vojvodë

Oh zot  
të mori djalli

---

<sup>2</sup> Prijës çetnik

## PRANIA IME A THUA TMERRON

Bie në krah të majtë  
jam unë  
Bie në krah të djathë  
prapë punë

Nga të biesh Shën<sup>3</sup>  
të pres unë  
Në tokë e qiell  
tapitë i kam

Bie në krah të majtë  
rrallon ti  
Bie në krah të djathtë  
e puth nënën në sy

Nga të bie Shën  
mungon ti  
E s'të dëgjon kush  
në tokë as në qiell

Prania ime a thua tmerron

---

<sup>3</sup> Shën – i shenjtë

## GJUHA E QENIT

Duke u marrë me Gjuhën e Qenit  
gjithnjë e më pak ndiej  
praninë e Njeriut

Për dhëmbin e verdhë  
e syrin e verbër  
as sharjet

Kriposini trupat  
për një kohë më të mirë  
gjuhë e Qenit iu zgjon  
edhe n'ëndërr

Të jetosh  
nuk po mjaftuaka  
vetëm të marrësh frymë



## RRËNIMI I PËRMENDORES SË TURPIT

Nëse nuk duan ta bëjnë publikisht  
unë kam forcë  
natën ta zgjas 48 orë  
ose sa lypset për ta rrënuar  
një përmendore<sup>4</sup>  
që s'i ka hije shqipes  
Të shihni atëherë  
një Popull e një Kryeqytet  
si lirohet nga ankthi  
Dhe në vendin e atij aziati  
Tribunin<sup>5</sup>  
tim popullor  
nëse nuk duan ta kthejnë  
unë kam forcë ta bëj edhe atë  
Do të bindeni atëherë  
se një Popull e një Kryeqytet  
mund të bëjë shumëçka  
për namin e vet të dikurshëm

---

<sup>4</sup> Fjala është për përmendoren e Stalinit në Tiranë. Poezia është shkruar një vit para se të rrënohej ajo.

<sup>5</sup> Tribuni popullor, Bajram Curri, luftëtar për çështjen shqiptare.

## NË MES QIRINJVE

S'e mbytën një morr  
dhe e shpallën Perandorinë  
Pushteti Popullor të kujdeset  
edhe për qefin e xhematë  
Gardhiqeve Evropa shqeu fustanin  
Na u ngatërrua rreth fjalëve  
Në bodrume shumohet populli  
Nga ajri jetohe nga qejfi  
Fëmijët vdesin duke luajtur  
me bishta minjsh me koka urithësh  
Satana ashtu ka dëshiruar  
Para muzgut fiken llampat  
Gratë kërkojnë strehimore  
të lindin ndërtuesit e Ardhmërisë  
dhe me nga një copë buzëqeshjeje  
ia prishin fytyrën të Plotfuqishmit  
Ku je mori Evropë  
Pas cullakhanës sate na ranë këmbët  
Një morr s'e mbytën  
dhe e shpallën Perandorinë  
Por kur bënë projektimin e Keopsit  
harruan vetëm

nevojtoret publike  
ku Populli  
ku Populli të zbrazet nga kapsllëku  
dhe Pushteti Popullor të marrë frymë lirisht  
në mes qirinjve

## VAJKËNGE

Është mirë  
mbasi jemi gjallë  
e hamë e pimë e lëvizim vendit

Perënditë ç'janë

Është mirë  
mbasi ende dhihemi lirisht  
e kallëzojmë përralla e syrin e s'ia heqim Majës  
Perënditë ç'janë

Është mirë  
në shtatë dryra që na mbyll fryma  
e borë bie mbi shpirtëra

Nga i ligu na i fsheh gjurmët

A harron populli  
edhe kur gjarpërinjtë  
shndërrohen në engjëj

Qyqe more  
oi oi  
oi

## XHIRIMI I NJË FILMI SEKRET

Mungonin rrënjë degë lisa vra rrufeje  
ujëra myshqe shtresore qetësia shurdhuese  
bari malarik thatësi vërshimë tropikale  
Mungonin shpella katakombe qytete  
të nëndheshme tërmete e sëmundje  
kaktuse luleshpata ndonjë vjollcë e stinës së pestë  
lozë kungujsh farë të zbrazëta  
oaza të vetmuara me hëna të përgjakura  
mbi shatorre mavi  
e përreth zalli i gjallë që vetëm gëlltit

Mungonin vendime ligje urdhëresa  
në pikë dite eskadrila  
në pikë nate ose  
në pikë ëndrre

Ndonjë qytet i rrënuar apo fshat i djegur  
me gjelin e fundit mbi hu gardhi  
Puse të pafundta e kapakë të artë mungonin

Se ishin dinozaurët kentaurët minotaruët  
gjarpërinjtë nga të gjitha llojet  
hijenat ujqërit korbat e bardhë

dhelpërat minjtë  
e kuajt e famshëm nga Troja që kishin ikur

Dikur kishin arritur dhe katallanjtë  
në përcjellje të sirenave vajtuese  
dhe klounët me fanfara e zjarre e thika  
matësit e tokave e pastruesit nga Hadi  
pastaj kasapët më në zë të Sorranisë

Në fund të skenës së errësuar ishin  
aty dikund edhe aktorët  
zgjedhur nga regjisori i padukshëm  
Gati ishin edhe maskat kamerat reflektorët  
e tërë makineria e hekurt  
Obobo krejt ç’duhet për një projekt  
madhështor  
ku është derdhur  
tërë mendja gjeniale e liliputanëve

Por ky film  
por ky film nuk do të shfaqet kurrë  
për shikuesit e artit të shtatë

Se Mungonin Se Ishin Se Filmi  
në bunker të Satanës të Sorranisë  
ishte kyçur veç  
kur vrapoja të lajmëroja botën  
për një hata që kishte ndodhur  
dikund atje në bisht Evropë.

## NË TEATRIN E RI

*Hans J. Lanksbit*

Nuk bën të vdiset i uritur  
Ushqeni njerëzit sa më mirë  
Plumbi i kap më lehtë  
Se Evropën e mbyti gjumi

As në metropole nuk shfaqet më  
Shekspiri as Eskili  
Ndizni TV dhe Sarajeva dhe Kosova  
A nuk meritojnë duartrokitje frenetike

Në Kasaphanë nuk shkohet  
i zdesur i dathur i ligështuar  
Lëndoni sedrën e satanës me namë  
Se Evropën e mbyti gjumi

Vdiset vetëm njëherë e Zoti  
nuk i pranon viktimat të zymta  
Përndryshe publik as xhelatë  
nuk do të ketë në teatrin e ri

*Feldafing, 10.7.1992*



## FATET

Në majë të gishtërinjve  
kalova Murin e Berlinit  
me një trëndafil në dorë

Frikësohesha se lëndoj  
shpirtrat e rënë  
ëndrrat

Sa desha ta kapërcej  
edhe Murin Shqiptar  
më ra para këmbëve  
koka ime në gjak e larë

Në të zeza veshur një grua  
kodrave fushave  
varrin ma kërkon

E trupi im  
çdo ditë zgjohet në mes jush  
Një torzo i tmershëm i qytetërimit

A nuk e shihni se akuzon

*Berlin, 22.6.1992*

# KURDISE ORËN MEGJITHATË

## TESTAMENTI

Dhe erdhi dita vogëlushi im  
kur fjalët  
do t'i shkruash me drojtje

Kur gjithçka do t'ia nisësh  
nga gërma e parë

Dhe më fal  
nëse nuk mund ta ruaj qetësinë  
nëse nuk do të kemi bukë e kripë e dritë  
nëse fëmijëria jote  
do të shkundet tmerrshëm rrugëve t'errta

Kohë t'egra trokasin pullazeve tona gërmuqe

Më fal vogëlushi im  
nëse nuk do të mund të të përcjell  
deri te pragu  
nëse ndonjë plumb dum-dum  
fluturon nga ti  
dhe tanket t'i shkapërderdhin lodrat

Ja dita plot tërmete vogëlushi im  
kur do të mësosh  
se njeriu është kafshë e bukur  
dhe kur fatin tënd  
në qiell e vizatoj me thonj

## NDJESË

Nuk janë yje vogëlushi im  
kokarda janë sy të shqyer  
vrerë e terr majë thikash

Nuk janë lodra vogëlushi im  
tanke janë çizme hataje  
Marshojnë nga ti rëndë o zot

Nuk janë sheqerka vogëlushi im  
helme janë Dorë e Zezë  
nateditë mbi ty i derdh  
e temjan

Në këtë haklitje shpirti  
ndjesë të kërkoj vogëlushi im  
nëse ndonjëherë të kam rrejtur  
se iku fashizmi

## DHJATË

Jeta po na përgatit edhe për më të keqen  
trimi im  
Ç'është dhembja apo gëzimi  
nuk dimë më

Kjo nuk është lufta jonë

Nga plumbi shëtitës kroat  
do të biesh ndoshta  
ose nga thika e ndryshkët serbe  
te ndonjë krua

Vdekja është e sigurt

Ma kthe shpinën edhe mua  
Jetën ma zgjat edhe për dy pëllëmbë  
Urti është ta kapërcesh flakën

Korba t'uritur në kufi fisesh  
duke iu lutur zotit për ty o bir  
zbardhem nën çatinë qiellore

Ajo nuk ishte lufta jonë

*14.X.1991*

## POEZIA QË NUK DO TA KRYEJ KURRË

Dhe do të vij dita  
kur do të thonë  
aty ku ka rënë Albana  
atje Shpendi  
aty ku ka ekzistuar filan shkolla  
atje bozhuristët  
kanë helmuar fëmijët

Në periferi na ishte  
Ulpiana Dardania  
Ç'u bë kështu me fisin tonë

Dhe do të vijë dita  
kur do të thonë  
hordhitë serbe kur kanë kaluar  
Dhe asgjë nuk do të besohet

Prandaj këtë poezi  
nuk do ta kryej kurrë  
është i tmerrshëm fundi i saj

## PËRDITSHMËRIA IME

Nadje herët më zgjon polici me automatik  
dhe rrëmihja e fqiut që hap varrin tim  
diku nën rrapin e çarë përgjysmë  
Pikërisht në dymbëdhjetë pa pesë minuta  
në dritaren time bie një zog qiejsh  
Rreth Shtëpisë bëj vrapimin e fundit ndoshta  
    Kokën e gungaftë ma qethin  
    M'i presin thonjtë plot dhe  
    Ma përgatisin ujin e të Premtes së Madhe  
Kah ora njëzet në përcjellje të avionëve supersonikë  
theqafjes vrapojnë tanket e përhirta  
për ta qitur në gjumë antikën e sakatosur  
në rezervat ku unë me durim ujis  
    Lulediellin e natës së qyqeve  
Pranë meje diku fqu i zbehtë vazhdon të hapë varrin tim  
    edhe për nja 13 cm  
    e të flasë me gishtërinj  
    nën kujdesin e policit me automatik

## KJO KA NDODHUR NDOSHTA PARA KRISHTIT

Dikur moti lexoja libra mbi fashizmin  
dhe shumë pak u besoja  
Para Krishtit ndoshta ka ndodhur kjo  
ose kur kthehesha nga Nazareti  
Në Llap atje kur u ndamë nga Ylfetja<sup>6</sup>  
dhe kur fëmijët e helmuar i mbuluam me çarçafë  
m'u kujtuan librat e pluhurosura  
gati të grisur nën trarë  
Ana Frank Ganimetja Ksenofona  
Deri kur deri kur njeriu t'i ndjekë  
xhindet nëpër shtëpi  
e hënë ta gjuajë gardhiqeve  
Dikur moti kjo ka ndodhur para Krishtit  
ndoshta shumë më herët  
se kur kthehesha nga Nazareti

---

<sup>6</sup> Ylfete Humolli, nxënëse e vrarë nga policët serbë në Kosovë.



## BUZËQESHJE NË KAFAZ

Derisa petritët agonët albanët  
çojnë dashuri  
me sorkadhe bubulina shqipe  
e zbardhen në vetmi  
në hijen e krahëve të korbave  
sheshelët e arkanët e gogolët  
argëtojnë kopilat e mëhallës  
klounët e mbramë të metropoleve të Evropës  
paketojnë kukulla në thasë najloni  
kyçin duartrokitje buzëqeshje në kafaz  
dhe i bartin tej vezullimave

## HIMNI I GAZIT

Edhe kur nuk ke bukë  
edhe kur ia vejnë dryrin Shkollës sate  
edhe kur djegin Librin tënd të shenjtë

– Qeshu vëlla

Edhe kur të shajnë  
edhe kur të ndjekin  
edhe kur të rrahin publikisht

– Qeshu vëlla

Edhe kur s'ke nga t'ia mbash  
edhe kur të vrasin  
dhe kur del te varret

– Qeshu vëlla

Dhe bindu një herë o i miri im  
me vdektarë ke punë  
dhe arma jote më e fortë  
është gazi

Ha ha haaa  
Lavdi  
Marrëzisë

## ATO NUK JANË VARRE

Nuk vdiset në Kosovë  
vetëm njerëzit shndërrohen  
në rrënjë në degë të një peme  
Kur të shfaqet Djalli  
të përgjaket  
ose të bjerë

Ato nuk janë varre

## KUR TË PRAJNË

Kur të prajnë avionët tanket çizmet  
edhe lehjet edhe sharjet edhe rrahjet

Kur të prajnë helmimet mallkimet rrethimet  
edhe klithjet edhe ndjekjet edhe vajet

Kur të prajnë muret çelësat mikrofonat  
edhe hatatë edhe trillimet edhe ëndrrat

Kur të prajnë fëmijët nënat trimat  
edhe varret edhe lugetërit edhe gjakrat

Poplli im do të këndojë apo vajtojë

## POESIE FORTE

A qan burri

Unë do të dëshiroja të qaj  
dhe të qaj vetëm njëherë  
nga gëzimi

Zot i madh si nuk më sheh qe sa vjet  
në mes kaq xhenazeve  
të të urtëve tu

Vërtitem poshtelart  
nuk mund e gjej një pëllëmbë tokë  
për varrin tim

Shteg për një selvi  
ku trimi të bën një sy gjumë  
pas një zjarrmie të tmerrshme

Do të qajë edhe burri njëherë

## ORA E GJIMNASTIKËS

Kush ushtron jeton më gjatë

Kërcim së largu

Kërcim së larti

Trehapëshi

Njëqind metërshi

Rreth Mollës së Kuqe

maratoni i fundit

Ushtroni edhe në fushë

edhe në shtrat

Ditenatë nateditë ushtroni

Ndikon në pastrimin e gjakut

në hapësirë në kujtesë

Ndikon në frymëmarrje

edhe në sigurinë e Fisit

Dhe kur të zdirgjeni në det  
do të bindeni  
Terrori i bardhë  
as fluskë sapuni  
Lartposhtë lëvizni  
Shpejt më shpejt sa më shpejt  
Ngjituni litarit të padukshëm  
mbi Botë

Në mbarim të Orës  
kur ta kapërceni edhe Kalin e Drunjtë  
do të kuptoni  
s'ishte gjë as Golgota

Kush ushtron jeton më gjatë  
më i bukur është  
dhe më larg e hedh Gurin

## SODITJE MBI GLOB

Bie dhe bie vazhdimisht  
Unë hap shuplakën  
Tokën ta fsheh nga goditja e hatashme  
Po shuplaka ime tepër e vogël  
Bie e bie vazhdimisht  
Fundin e di vetëm unë  
Në maskenball Derrri ngre gotë  
Po Derrri a bëhet Njeri  
Mbledh shuplakën e përgjakur  
Nga thërmitë bëj portretin tënd  
Dhe mbi Glob vezullon  
Syri im  
Megjithatë Ti je fitues  
Maskën ia hoqe Derrit  
A sheh  
Dhe Orakullin e Dodonës<sup>7</sup> e zgjove më në fund  
Mbrapsht e kishte kurdisur Orën  
Kur u nise ta pushtosh Majën.

---

<sup>7</sup> Faltorja më e njohur ilire. Gjetet në Çamëri.



## NJERËZIT E AKULLT

Vetëm shpirti na mbet e dashur  
Ç'patëm  
Na mori Mortja

Shikoje Shkretëtirën si na pushton

Degëve të zhveshura  
njerëzit e akullt  
djerrinave dalin futë

Grimcojnë kokën e përgjumur të Antikës  
tmerrshëm grimcojnë  
minj gjirizash

Shkarravisin fytyra perëndish të rremë  
me degë të thara  
me shpuza të zeza mbulojnë sytha

Na duan vdekjen solemne  
Teatër antik  
kurrë nuk kanë parë  
Zbritur s'kanë as në Dodonë

Shikoje Shkretëtirën pashë zotin  
na i përbin edhe trupat  
edhe nishanat

Njerëzit akullt  
veshur në të zeza  
flutura të kaltra gjuajnë

Oh e dashur  
edhe një pikë ujë  
se më doli flaka

## KURDISE ORËN MEGJITHATË

M'u sos edhe lëkura  
duke arnuar  
plogët e Kullës

Nga të gjitha anët fryn  
e gjarpërinjtë s'i lënë fëmijët  
të rriten  
Deri kur  
të të qesin  
në Pazar

Kurdise orën megjithatë  
Nuk di  
kur do të kthehem

## ATY KU NGRIN FLUTURIMI

### LUTJUNI ZOTIT TUAJ

Ai që ndërron flamurin  
mësohet t'i ndërrojë  
edhe zotërinjtë  
Lutjuni më mirë Zotit Tuaj  
Në Majë të Majës  
do t'iu shpierë i gëzuari  
edhe pse qorr  
e shurdhan  
është

## HISTORI QENI

Ashtu e kishte mësuar Zotëria  
Të lehë vetëm në sojin e vet

Llahtarinë s'di a e pa kush pastaj  
E akullt toka ishte e qielli bosh

Nga vetvetja kur u gërdit  
vari një gur rreth qafe të zhugaftë

Te këmba e të Zot aty në pus ra  
Ta lë të qetë botën njëherë tha

Dhe lebetitjet e kohërat e hijet  
i mbështolli me lëkurën e vet

Ai nuk ishte një qen i zakonshëm

## BIRI I BUSHTRËS

Ai tha: Mbasi u përlyva  
ta përlyej edhe Pasqyrën  
Mos dukem pakëz  
më i pastër

Por Dri  
as Llap  
s'e lau

Në kep një mot u shqerr  
të shpëtoj nga ky vrer  
do t'i humb fërkemët  
dhe në ferr

Ndërroi emër e komb e atdhe

Dhe iku me shira e re  
i vuajtur  
i përmutur  
i humbur

Qen bir qeni na ishte ai

## MAGNUS

Poet i madh është më i madhi padyshim  
Për dallim nga poetët mediokër  
Ai i rrit thonjtë e i mpreh me thikë kasapi  
Ia heq të gjitha dregëzat të Dashurës syshkruar  
të cilën çdo mëngjese e rreh me kamxhik  
pse nuk e ka zgjuar më herët  
Ajo e di pse e rrah Ai  
mbasi kurrë nuk ia pa herdhjet tamam  
në shtrat as në log  
Deri te thembra Poeti i Madh  
    ka edhe një shall  
    dhe një pallto alla evropiançe  
Nuk frikëson nga flama  
    por pse Bota çalamane  
nuk dëshiron t'i kollitet pas  
kur del në takim i veshur në purpur  
dhe kur shkon për ta parë përmendoren e vet  
midis sheshit Tum Mut

## ROBI I ZOTIT

Zoti është i madh  
dhe i rëndë dënimi i tij  
Por pëshurr lirinë  
që ma ofron Robi i Zotit  
Nga varr im i quajtur Sistem  
të përshëndes Kep i Djallit  
me një gjeth pelini



## PERËNDITË DHE MINJTË

Më lehtë e pata me perëndi  
për në Albanopolis kur udhëtoja  
Ata dinin edhe me vra  
edhe më falë

Po këta minjtë vetëm shumohen  
e grimcojnë tmerrshëm  
e s'dinë  
as të vrasin

## PASTRIMI SHPIRTËROR

Nëse vdes  
vdis për çështjen tënde të hapur  
Qyqari di vetëm të përsosë mjeshtërinë e dhunës

Nëse vdes  
vdis për të mundurit e botës  
Dhunti engjëjlore është ajo

Gjaksin mos e ndiq  
herëdokur do ta zë  
veshin

Nganjëherë lypset  
varur njeriun edhe për bole  
për ta liruar nga djallëzia shkatërruese

## DUA TË JETOJ

Thonin se ishe  
diku në fillim  
Unë të kam parë gjithmonë  
në fund  
me kokë ndër duar  
Nesër kushedi ku të gjej  
Vendi yt lëviz si varr  
derisa të të nxjerrin  
edhe jashtë Rrethit të Kuq  
Unë megjithatë vazhdoj  
t'i shtrëngoj dhëmbët  
Dua të jetoj

## KATRORI MAGJIK

*Adem Demaçit*

Tani gjendesh  
brenda katrorit magjik  
dhe kërkon Kosovën në hartën e vezullimeve  
Jugu e Lindja Veriu e Perëndimi  
katër kapakë të mbyllur  
të një ëndrre

Tej grilave përcjell fluturimin e dallëndysheve  
se besimi  
drejtpeshimi i lirisë

Ciatje gjarpërinjsh  
rreth gishtit të ngritur  
nga Zoti

Dhe pika e gjakut vizaton Diellin

Katrori magjik  
është fatal  
po qe se bie brenda tij

Në cilën anë do të zgjohet Kosova

## Ç'VRASËS MË PRET

Të kaluarës vërimi pikë ju lutem  
Ajo vazhdon të jetë edhe më ilire

Para dyerve të hekurta dua të di  
ç'vrasës më pret

A do të mashtrohem edhe më nga barbarët  
dhe a do të merrem prapë me vetveten

Ju lutem të kaluarës vërimi pikë  
Ilire edhe më vazhdon të jetë ajo

## MURI APO UNË

Nën këmbë rrëshqet toka  
Mbi ballë qielli krah nëne  
Brendejashtë meje lëviz diçka  
Muri bie apo zgjohem unë Oh zot

## XHENAZJA

Dekën ia pashë  
dhe ia dëgjoj gjamën  
Mbi dhe xhenazja  
Fëmijët a na i ha më

## SHTËPIA PA ZOT

Vdiq pa çelur një dritare

Shtëpia mbet  
edhe pa Derë  
se na u ndryshk Çelësi

Oxhaku u shndërrua  
në një lejlek  
të zgjebosur  
Në fund të Livadhit të Kositur  
me gishtërinjtë në gojë  
presim  
se kur do të tymojë

A jeto het me ëndrra



## FUNDI I LOJËS

Ne do të vdesim  
secili në mënyrë të vet

Dhe me vete do t'i marrim  
edhe vrasësit tanë

Por triumfi  
a është edhe fundi i lojës

## NGA FUNDI I NJË ZEZONE

Në Kutu të Nënës vë Fluturën  
Ngjitem në katin më të lartë të Rrokaqiellit  
Ndjek minjtë në hapësirën e ngrirë  
Gjarpri i verdhë fishkëllon plasarinave të mureve  
Me sy të harruar në Ulpianë  
kthen Dreni para muzgut  
Në pëlhurë të vetmisë  
Donika qëndis lulet e fëmijërisë  
Në gjemborë përgjak duart Genti  
Pas lajmeve të fundit për Kosovën  
më kapërdin terri i akullt  
dhe nga maja e gishtërinjve  
deri në tepe të kokës  
më kalërojnë minjtë  
Mbi biçikletë pret ende Petriti  
    kur Dielli  
    do të kalojë edhe pragun tonë  
Por fqiu oh fqiu i ziu  
    shtron udhën me xhama  
    e fjalët qelbanike  
    llastikë në qiell  
Nganjëherë plehu than edhe gurin  
    lëre më ta rritë  
    Lulediellin tim

## GJUMË TË MIRË E DASHUR

Çelësi nuk është tek unë  
Çelësi gjendet te ti e dashur  
Shtëpia prandaj na u mbush  
    minj gjarpërinj ujq  
Po qe se ke guxim  
Çil kapexhikun ta shoh fytyrën  
    hënë të rrumbullakët  
Murin e rrënoj unë  
Dhe minjtë dhe gjarpërinjtë dhe ujqit  
    nuk do t'i zërë vrimë e zezë e Dheut  
Vetëm Çelësi është te ti  
    Në perla tua dikund  
    gjumë të mirë e dashur  
    Të lodhi kolla

## DO T'I THEM TË NJËJTAT FJALË

Kur kufjen s'e ngritim  
më mirë kuptohemi e dashur  
Jemi një shpirt e një trup

E di se Ti rri atëherë  
pranë Dritares së zymtë  
e më kërkon në mes yjesh në mes valësh

Ndërkaq unë në dhomën 2 me 2  
larg teje njëqind vjet dritë  
shtrydh edhe pikën e fundit të gjakut

Nëpër mure të grithura  
vizatoj: fytyrën sytë  
flokët tu detin

Edhe pa u dëgjuar edhe pa u parë  
ne dëgjohe mi e dashur  
dhe shihemi aq bukur në fund të Pusit

Le të mbesin fshehtësi edhe dashuria  
edhe shpirti  
edhe pëshpëritjet

Policia e fshehtë  
përderisa t'i deshifrojë ëndrrat  
Gjarpri shndërrohet në Lule

Më mirë mos e ngrit kufjen e dashur  
Edhe pas një mijë vjetësh  
do t'i them të njëjtat fjalë.

## LIBRI I PAKRYER

### Tercina I

Më vajti jeta  
duke hequr fletë  
nga Libri i pakryer

### Tercina II

Shkundu pemë  
Të thahet rrënja  
Krimbi arriti në Majë

### Tercina III

Mbyll gojën  
Ajrin na ndote  
Ferrit i bihet edhe në këmbë

## UNË DO TË KISHA ATDHE

Të kanë rrejtur  
se je më i bukuri  
ndër trimat më trimi  
më i vjetri ndër të moçmit

T'jetër kush do të ishe

Të kanë rrejtur  
se nënë ke ulkonjën  
krahët e orakullit  
se pi ujë në gurra të Drinit

T'jetër kush do të ishe

Të kanë rrejtur  
se je Zot i Dheut  
se je Zjarr i Fshehur  
se mbi Pashtrik hapet Qielli  
e pikë terri në pjatë të Djallit

T'jetër kush do të ishe

Dhe unë do të kisha Atdhe.

## PARA SE TA FIK LLAMBËN

Vlen të rrish një vit pa gjumë  
çudira mbi çudira të dëgjosh nga Gaboja<sup>8</sup>  
gardhiqet ballkanike t'i harrosh për një çast  
Me minj me arinj me gjithfarë kafshësh  
edhe kështu qytetet tona plym  
Diku atje në Raguzë hija e të madhit<sup>9</sup>  
a lëviz ende  
apo lindet nga kanalizimi nga gjiri nga varri  
Më mirë që nuk është gjallë  
miku im Jure Kashtellan<sup>10</sup>

Qellit kushedi ç'fjalë do të vetëtinte  
ç'namë do të binte mbi ata  
që ia përdhosën Atdheun e poezisë  
Unë nuk di edhe sa kohë do të kem  
Ndoshta kurrë s'do ta kryej së lexuari  
romanin më të ri të Markezit  
Gabo i dashur përfundoji çudirat mahnitëse  
para se ta fik llambën  
Mbi dritare Hënës i kuqlohen faqet.

---

<sup>8</sup> Emër përgëdhelës për Markezin.

<sup>9</sup> Raguzë (Dubrovniku) në kohën e Skënderbeut ishte edhe liman shqiptar.

<sup>10</sup> Poet kroat.



## UDHËTIM ME UJQ

Udhëtimi me ujq është më se interesant  
Tek kur nisesh Pyllit  
zbulon fytyrën tënde të vërtetë

Udha mund të zgjasë më shumë se ke vjet  
po ndodh  
ta kalosh edhe me një vrap kali

Ai që nuk ka bërë udhë me ta  
nuk di ç'është liria  
as këmisha e yjeve

Ta kesh të qartë  
pa humbur një krah apo një sy  
nuk e çel derën lirisht

Nga qielli  
s'po pikoka  
asgjë.

*Feldafing 6. 6. 1991*

## LEXUESIT E VDEKUR

Në hijen e Malit grithin fytyrën e tokës  
mos ia nxjerrim zërat paganë të të parëve  
dhe shkruajmë librat në lëkurën e drurit mijëvjeçar  
Po librat kush të na i lexojë në këtë pis kohë  
kur po vdesin lexuesit duke nxënë  
    xixëllonja e hëngër dredhëza  
Koka ujqërish gjarpërinjsh minjsh  
    pushtojnë edhe letrën e bardhë.

## GUASKA

### *Xhevahir Spahiut*

Një valë e largët nga fundi  
Nxori në Breg një guaskë  
Udhëtoi e udhëtoi pastaj ajo  
në time shuplakë u hap dikur

Ç'botë e çuditshme vezullimesh  
Tatëpjetë flet më shumë se  
një kohë se një popull i nakatosur  
sa Vdekjes s'i frikohem më

Me ditë e dëgjoj edhe lutem  
për fjalën e mikut tim t'urtë  
qetësi që më fal e shpresë  
në këtë kohë pabesie e laku

Mbi tryezë mermeri rri guaska  
me fytyrë nga vetvetja mbyllem  
Ndoshta më merr edhe mua Vala  
Bregut të Mikut të më hedhë

Ndoj fëmijë të më hapë 'i verë  
kur të vdesin dinozaurët modernë.

*1990*

## ATDHEU I MBËRTHYER NË ARKË

*Martin Camajt*

Del në mëngjes Evropës  
për një lutje fisi  
Shpirtin asgjë nuk ta qetëson

Në mbrëmje kthehesh dikur vonë  
dhe kur zonja Evropë  
mbyll dhe syrin tjetër

Nxjerr nga arka Atdheun  
dhe në dritë të hënës  
e peshon në shuplakë

Damar pas damari e shpalon  
kushedi për të satën herë  
duke i gjetur kuptime të reja

Të bëhet se të thërret ndoj zot i harruar  
të bëhet se kush ikën  
nga përqaftimi i llahtarshëm

Vë veshin pastaj dhe dëgjon trokun  
mes Drinit të Bardhë e të Zi  
që vetëm ti e kupton

Me ferk mbërthen Atdheun në arkë  
dhe merr Evropën në sy  
i bindur se asgjë nuk peshon më rëndë

Në hall na qite Burrë Malcic  
me ata zëra pagan bubullimë Dheu  
me ato ethe Arbërie

*1991*

## NË SHTËPINË E MARTIN CAMAJT

*Erikës, bashkëshortes së poetit*

Gjithçka i vinte era Dukagjin  
Aty ishte edhe Dranja dhe Temali  
pastaj Oda e burrave me qilima Peje  
dhe Llahuta në ballë oxhaku  
    punuar nga lëkura e Buallit të Drinit  
    nga një artist anonim  
    që e kishte qitur belaja në Rrafsh  
Vetëm mungonte i zoti i shtëpisë  
i cili kishte dalur  
    për pak kohë  
për ta kërkuar të Madhin  
kreshtës së Malit  
    Aty ku ngrin fluturimi i shqipes  
    e fillon  
    ëndrra

*Lenggris, 16.5.1992*

## TAKIM ME ZOTIN E HARRUAR

*Gjelosh Gjokajt*

Mbasi mësuam se vija  
nga një popull antik

Më morën e më vendosën  
në një Kështjellë mesjetare

Të jesh pranë Qiellit më thanë  
Zotit ia paske kthyer shpinën

Nën shputat e rjepura  
ende ndieja ngrohtësinë e ujërave të Ballkanit

Megjithatë flad i Alpeve  
më rrihte në të katër anët

Dhe trupin e dërmuar Golgotës  
ma zhvishte nga mjegullat

*Feldafing, 20.4.1992*

## ANIJA E BARDHË

*Ilirian Zhupës*

Një anije e bardhë në horizont  
aq e bardhë është  
sa e urrej

(Edhe në pikë nate  
kur më zgjon  
Xhevahir Spahiu  
bardhësi e saj më tmerron)

Qetë shket valëve në hijen e Alpeve  
për t'ia pasur lakmi  
edhe vdekjen fshehur në guaskë

Në gjurmë mos i rashë  
nositit tim idhnaq  
nga krahu i Lasgushit  
qiejve që u mbyll

Çative të Ohrisë kur e gjuaja hënën

*Shtarnberg, 2.6.1992*



## KUR U ZGJUAM

### PLAGË E GJALLË

Përditë zbres te Liqeni i Shtarnbergut  
ku vazhdojnë të shtohen peshqit  
për t'i argëtuar edhe ata të Dheut të Huaj  
Mbi tepe kreje nga fundi i ditës  
shoh vetëm zogun e vendlindjes së shthurur  
duke u mbyllur në plagë të gjallë

*Feldafing, 10.4.1992*

## SHQIPTARËT

Zoti nuk u kishte falur as bar  
vetëm gjarpërinj  
e gurë

Por ata kishin diçka  
që kurrë s'mund ua zbuloi i madhi  
Jetonin gjatë

Dhe kur vdisnin  
vdisnin  
duke kënduar oi oi oi

Te koka  
u mbinte  
nga një rrap i çarë më dysh.

*Feldafing, 15.5.1992*

OSE, OSE

Nëse të merr malli  
t'i shohësh shqiptarët  
dil në stacionet e metropoleve

Këpucë të ngrëna  
kanë ata  
e çorape të bardha

Ose ose

Në Marlenplatz  
apo te Kullë e Ejfelit  
fishkëlleje një këngë trimërie

Rreth vete  
deri në një  
tok i ke ato fytyra të ngrira

E mos u frikëso atëherë  
se të ligështon vetmia  
Ajo egërsi e tmerrshme qytetërimi

*Munih, 18.4.1992*

## NË ZGRIPC

Gjaku nuk na qenka më  
fuqi magjike  
as liria dhuratë perëndish

Lajme lajme lajme  
dhe kolona e refugjatëve  
mbështolli Globin

Në cung do e veja kokën  
se fat i Kosovës  
fshihet Evropës

Varr se varr  
më i sigurt  
imi

*Feldafing, 17.4.1992*

## KLITHJE NË SHPELLË

Të shoh vazhdimisht më larg

Pus i pafund  
ma gëlltiti  
edhe Qiellin mbi kokë

Kosovë  
këmishë e ime e përgjakur

Krizanteme  
e selvi  
ç'po të mbulojnë

E unë t'i numëroj plagët  
dhe kullat e rrënuara  
dhe varret

Kosovë  
klithje në shpellë

*Feldafing, 20.5.1992*

## NJË DITË TEPËR SHUMË

Një ditë më herët ose më vonë  
nuk do të thotë kurrgjë  
për Evropën

Ndërkaq për Kosovën  
tepër shumë  
Më tepër se një dhëmbje  
më pak se një dashuri

Sa larg më le  
nga bregu i ëndrrës  
Nënë

*Feldafing, 14.5.1992*

NË ZINDANE

Ç'është tepër  
tepër  
është

Një jetë e diçka  
në nofulla ujku

Oh Nënë  
Në valë të Drinit  
të më hidheshe më mirë

Do të më gjente Gjergji  
diku në Detin Jon

E Malin s'do ta hante Sopata

Ç'është tepër  
tepër  
është

Një jetë e diçka në zindane

*Feldafing, 12.5.1992*

## DËSHMI

Shkoi Isa

dhe Deda

dhe Baca Bajram

pastaj Kadriu<sup>11</sup>

dhe mbeta kalli

Dikush duhet t'i zgjojë ata grykave

e dikush të dëshmojë

se kemi ekzistuar

---

<sup>11</sup> Kadri Kusari, intelektual i shquar nga Gjakova, i cili pas 12 vjet robërie vdiq i vetmuar.



## ELEGJI

Në një kohë tjetër  
Lindur të kisha  
Drininë s'do ta gërryente Urithi

Do të isha 'i lis i drejtë  
me diell  
mbi vetull e mollë në shtizë

Tani i thyej dhëmbët  
me kurrkushin  
e pres të hapet Qielli i Verdhë

Nuk ta di as varrin miku im  
Bie këndeje apo andej  
Murit të Arbërit

*Feldafing, 9.5.1992*

## YRNEK I KEQ

Bëmë ç'ka nuk bëmë  
Dreqin te dera  
nuk ua lamë

Po qe se takoni udhës  
fjalë të gjymtuara  
Tonat janë ato

Ca na i gëlltiti  
merimangë e kuqe  
ca lindën para kohe

Ju lutem respekt

Yrnek i tmerrshëm  
si nuk duhet  
jetuar

*Feldafing, 18.5.1992*

## GOLFI

Problem i vetëm

vrina midis fushe  
dhe fluturimi i fuqishëm i topit  
drejt saj

Dhe ka ditë lojtarëve të djersitur

topin jashtë fushe  
ua kthen Petriti  
me një buzëqeshje karakteristike

Por unë njoh një njeri

me një vrimë të zezë në kokë  
ku frikon t'i hedhë vezët  
dhe gjarpri

Loja e golfit mos po bëhet

problem i përgjithshëm

*Feldafing, 17.5.1992*

## PASANIKU E KA QENIN

Hajni ja mësyen fukarasë  
se pasaniku  
e ka qenin

*Feldafing, 11.5.1992*

## FOTOGRAFIA JONË OSE ETNIA

Gjymtimi yt pikëllon edhe në ëndërr  
Zogun ma tremb në dritare të hijesuar  
dhe ma kujton cungun në pyll rrufesh  
Me katër faqe drite të dua të plotë  
Dielli kur të dalë majë Tomorrit  
    apo tehut të Pashtrikut  
të ma ndritë Fytyrën skaj më skaj  
    Gjuhës së Nënës  
    deri në Dodonë  
Nyje t'i lidh Dri e Jon rreth Dheut  
Pesha e fatit më është më e lehtë  
Fotografinë tonë të verdhë e dashur  
hajmali ta kenë fëmijët  
në gjah kur të venë  
    Brenda zhgëndrrës  
    prore zgjohet Atdheu

*Feldafing, 12.6.1992*

## KËMISHA IME

Kurrë nuk më ka rënë ngusht  
Netëve të gjata dimërore e punoi Nëna  
kur më tregonte përralla të çuditshme për xhindët

Në degë nuk di kush e paska varur  
Ajo ka vdekur moti  
e këmisha në gjak mbytur na qenka

Orë e ças ndërron pamje  
Dhe në ngjyrën e saj të pazakonshme  
shoh fytyrën e pikëlluar të Nënës si lëviz

Në katër anët e rreh era  
po të teret  
s'e lë gjaku

Valon këmisha ime lart në degë  
herë nga dielli  
herë hija e fsheh nën sqetull

Në rrënjë gjaku e than Plepën e Shtëpisë  
E nën kurorën e tij të tmerrshme  
Evropa bën gjumë ariu

Medet për duart e Nënës  
Vdekjes shkova  
t'ia vesh Këmishën time

*Feldafing, 18.6.1992*

## PËRSHËNDETJET E FUNDIT

Shamëni sa të doni të mirët e mi  
T'iu dëgjoj nuk kam veshë  
se tmerrësisht ju dua  
As kam ku t'iu shpie  
se harrimi s'është fundi  
dhe zgërdhuhuni edhe më  
Nga hija ime njerëzore  
nuk do të lirohi kurrë  
As do të mund të ik nga ju  
shpirt e gjak ju kam  
Hoqët dorë edhe nga vetja  
do të kyç vetëm poezinë  
rrebelimi im pagan t'u shtrydhë  
te Muri i Turpit si qelb kohe  
Nga hilja të dliir besimin  
Tej Dardanisë e Dodone  
gjërë e gjatë të shtrihem  
me 'i fyell në buzë të luluara  
gjethe të më mbulojnë e ëndrra

*Lajpcig, 24.6.1992*



## ORË NGA ETIKA

Nuk më pëlqejnë ata  
që i kallëxojnë dhëmbët shpesh  
As ata që nuk dinë të qeshin

Ujku i Çalë më shfaqet  
mbi Vijë të Mullirit  
Kur grigjën përgjakte

Lypsen të reja nga etika  
se bontoni i pamjaftueshëm  
për racën njerëzore

Nëse mjafton një jetë  
për lirinë e njeriut  
Ja koka ime

Nga thika bizantine më kurseni ju lutem  
Shushurimën e Drinit ta dëgjoj dua  
nën Urë të Shenjtë

*Feldafing, 17.6.1992*

## SALZBURGU NË SHI

Kur të shkosh në Salzburg  
lutju zotit të bjerë shi  
Nuk do ta harrosh kurrë

Zëri i largët të shëtit  
katakombeve të panjohura  
se nuk je udhëtar i rëndomtë

Do ta shpalosh nga brenda  
dhe nga brenda do të digjesh  
dritën e vetmuar duke kërkuar

S'është muzika vetëm tingull  
as bukuria shkëlqim verbues  
Udhëton në një kohë të tretë

Në Salzburg kur të shkosh  
shi të bjerë lutju zotit  
Më shumë do ta dashurosh dhe

fat ke pasur se tërë kohën  
nën mbrojtje të Moxartit ke qenë  
atje ku s'vdesin perënditë

*Salzburg-Feldafing, 10-15.4.1993*

## LIRIA ËSHTEË E TMERRSHME

Dikund i kam parë këto fytyra  
Dikund jam takuar me këta njerëz  
Edhe këtë muzikë e kam dëgjuar  
Ndoshta vëllau im Aleksandër Moisiu  
ma ka dërguar ndonjë kartpostale  
Nga Salzburgu nga Vjena  
Ose në ndonjë shirit filmi  
ka mbyllur tërë këtë madhështi shpirtërore  
para Vdekjes të më trimërojë  
Këto fytyra i kam parë dikund  
Dhe kjo muzikë më ka zgjuar shpesh  
Ndoshta Lojza dhe unë si djerraditës të fundshekullit  
Evropës kur kërkonim Ludwigun  
atë gjurmues të madh atlantidash  
Majë thikave ja ngjitem duarthatë këmbëzbathur  
Qetësinë mbretërore të Villa Waldbertës  
në Ballkanin e lulëkuqeve ta hap  
Nga Golgota ime të kujtoj një çast të lumtur  
Në shpinë të breshkës  
ishte e tmerrshme çdo gjë  
edhe liria

*Feldafing, 25.7.1992*

## NUK JAM VETËM

Këputur deri në shpirt nga udhë e nëmur e Jugut  
'i diell i padukshëm ma ngrohte trupin e dergjur  
te këmbët e mia që shpërtheu nga pikë e shiut

E krahët e shpëluar të Salzburgut të përgjumur  
turpshëm i fshihja nën çadrën trime të shqyer  
Nata ballkanike ulëronte thellë edhe në Evropë

Në gjunjë dikur rashë para një zonje të rëndë  
Lotët e mi i pija në sytë e saj të thellë  
A jam unë ai që del nga Dheu apo vrasësi im

Në një labirinth vezullimash kisha humbur  
kur më zgjoi maestro plak i cili kishte hapur  
krahët mbi mua si një zot i lashtë Ilirie

Mbi kokën time të hutuar fikte një nga një  
rrufetë e ndezura e hirin barte 'i lumë ëndrrë  
Pashë se nuk jam vetëm në udhën e lirisë

*Salzburg-Feldafing, qershor, 1992*

## VARRI NËN ULLINJ

Ra nata e vdekshme  
Gjamët i mbyti  
deti

Era e shkrumuar bredha pa krye  
plisa tirqe opinga  
shkund

Plasarinave përbihet vdekja  
dhe korbon  
Pëllumbi

E therur ra nata  
Trupa të coptuar  
fsheh

Nga një copë qiell të vendlindjes  
bartnin në sy  
të ndezur

Dhe kur morën udhë  
i bardhë ishte  
Pëllumbi

Nën kurora të ullinjve  
zbathur një vashë flokëprerë  
qan të dashurin që nuk është më

E mua ka vjet  
nuk më zë gjumi  
nuk më zë gjumi  
nuk më zë gjumi

*Tivar, 1986*

## KUR U ZGJUAM

Kur u zgjuam  
ishim vishkull  
fshiheshim nga vetvetja

Ujërat na i k'in bartur edhe ëndrrat  
dhe lëshuar na i k'in qentë  
dhe rrëzuar na i k'in gardhiqet

Deri në Majë të Majës kundërmonde bar minjsh

Kur u zgjuam  
plojë i kishte bërë vathët  
Ujk i Çalë

E fluturimin e zogut  
e buzëqeshjen e fëmijës  
e fytyrën e Nënës i kishim relikte

Tani shikojmë Qiellin e Verdhë kah hapet  
dhe në shpinë bartim Malin e Ulërimave  
derisa të na harrojnë të vdekurit





# **ISHULLI ALBANIA**

Rilindja, Prishtinë, 1998



SHENJA

E shënove cakun  
mos lë  
pa e rrëzuar

Shkrehe derisa ta qëllosh

Nuk të shkrep  
fatkob je  
qyqe

Nuk kanë me të k'nue

## ISHULLI ALBANIA

### KORBI

Po ku u shfaq ai shpend i hijeve  
në ekranin tim  
kur verbon bardhësia e Bjeshkëve të Nemuna  
Krrokamë e tij e lemeritshme  
të vdekurit frikëson gjarpërinjtë  
derdh bjeshkë ujërave ua ndërron rrjedhën  
Nuk pipëtin asgjë  
nën krahun e tij të rrëmbyeshëm  
I urtë mbret i Shkretëtirës Kukunënë  
Lejomë të dal në Sukën time  
të kullos Grigjën  
ujqit pa zbritur nga gërmadha të vetmisë  
shtizën e flakët i thashë tek hidhja  
në rrathë të panumërt rreth frymës sime  
Por në ekranin planetar vetëm një pikë  
Nuk është e bardhë  
E u përbe në tokë e qiell  
se shpend nate nuk është  
kur ra në supe të njerëzve të shndërruar  
në kaktusë gjigantë  
rreth Ishullit *Albania*  
ajo hije e mistershme  
Kep Pikëllime

## PASQYRA E THYER

Pasi çelësat e vetmisë i kishte hedhur në një hon  
Robinson Kruso nga Oqeania kishte braktisur Ishullin  
për shkak të *Shqipërisë* që e kishte zbuluar rastësisht  
tek lexonte një pergamenë Dhe në mbyllje të mileniumit  
të sertë sapo kishte shkelur aty ishte mahnitur me fluturimin e  
lartë të shqipeve:

Po si jetonit

Ne bënim se vepronim  
Ata bënë se na shpërblenin  
Ashtu jetonim As në tokë as në qiell

A shihnit ëndrra

Të ëndërronim nuk guxonim  
As të flisnim  
Nuk kishim gjumë

Varur rrinim për një fije merimange

Herë na hidhnin tej Gropave të Zeza  
Herë na mbyllnin  
Këndej Ujit të Madh

Vetë ne ato i çelnim vetë ne ato i mbyllnim

Lesh arapi kjo Shqipëria

As punonin

As ëndërronin

E jetonin

Dhe zotëria veshur në xhins nga Oqeania që e njihnin  
si Robinson Kruso nga lektyra e vetmisë njerëzore  
ishte parë për herë të fundit në tavernën *Iliria* duke pirë  
uiski me rebeluesin e quajtur F. Konica Nuk dihet pastaj ç'kishte  
ndodhur Ishulli *Albania* vazhdon të mbetet i rrethuar nga  
shqiptarët trima Më vonë nuk lajmëruan as agjenturat e fuqive  
të mëdha për të çarat katastrofale mbi Majën e Tomorrit në  
drejtim të së cilës notonte në ajrin e dendur *Varka* e Krusosë

## NEGATIVI I FOTOGRAFISË

Xhami i derdhur  
Nuk shihet më Grigja  
as i zoti  
Ndonjë re pluhur ndonjë klithmë e mbytur  
                    ndonjë shpirt i mekur  
mbulon Malin e zënë në shkundullimë  
Terri i dheut i gjakut i dashurisë  
                    hapet mbi bimë të verdha  
Se ra në Bunë  
në Vjosë Se ra në Dri  
Majë e perëndive ilire  
Bisht ëndrre copëza fjalësh shkronja të frikësuara  
thonj të përgjakur  
në qiellin e zbrazët  
vijëzojnë fytyrën e një engjëlli  
Shqipëri moj  
mos qofsh e zeza  
ime

*Ulqin, qershor 1997*





## KULLA E BALSHAJVE

I rri afër zotit  
se nuk u zihet besë  
as njerëzve

Kur dielli godet në kokë  
bie në gjunj para Ujit të Madh  
Sytë i lan në shuplaka të engjujve

E një zog i qëmotshëm ngrin në ajër  
përderisa të zgjohet Bindi  
erërat vdektare t'i lidhë për rrënjë ulliri

Kush u ngjit aty  
harroi diçka të marrë  
dhe Zotin nuk e troi kurrë më

*Ulqin, qershor 1997*

## DRITARJA E HAPUR

E pastaj

Asgjë nuk ka lëvizur  
Aty Guri  
që nuk na lë ta bëjmë Arbërinë

Pak më tutje  
Uji i Madh  
dhe Syri i Gastartë që vezullon

E në fund

E në fund të fundit  
Varka e Noit  
Por nuk e shohim Bregun

*Ulqin, korrik 1996*

## PËRMBYTJA E RE

Kush mbytet në mua  
nuk e ka parë më  
Majën e Fushëkosovës

Ai që e këputi pemën  
në degën time  
bekoi: Zoti e shpëtoftë  
këtë vend

Në gurin e mortshëm  
vuri kokën  
hapi shpirtin tim  
si një libër të vjetër

Dhe kallëzojnë të gjallët  
vite shekuj shkuan  
dot nuk e mbyll

Përmbi Ujit të Madh  
trupit im noton planet i ndezur  
me një therrë në sy

## MBRETI I VENDIT TË VOGËL

Asgjë nuk na tregon  
ku nis e ku mbaron  
ai farë vendi i vogël  
Në mes këmbëve të femrës  
apo majë thikës  
Rri si mut farë e mutit  
Një qytetërim i lashtë  
shpërngulet në libra të grisur nga minjtë  
    në fjalë të pathëna  
    në kujtesë  
Po guximi vizioni  
Orë e ças ndërron imazhi  
Me gishtin e vogël mbretëror  
dëlir hundët  
nga bloza e ëndrrave  
E nuk na thua një fjalë  
    në cilën anë zgjohemi  
Si një copë muti  
na hedh valë e verbër  
në kanalizimin e padukshëm

## KUAJT E COFTË

As sot  
As sot zotëri

Aty janë

Po ku tjetër zotëri  
Janë cullakuar  
Përmorrtesohen

Do të thotë

Do të thotë zotëri  
Mutësihane  
Miu polli Macen

Me një sopat në krah  
i kishte hyrë  
Pyllit

Oh Zot  
Në fushë  
kullotnin kuajt e coftë

## SHESHET E ZBRAZËTA TË EVROPËS

Boshllëku njerëzor  
arriti pikën kritike

Për take të harruara të mikeshave të natës  
gjahtarë të marrë  
lidhin qen racash

Sheshe të zbrazëta që nuk u shihet fundi  
kafshojnë më rëndë  
se gjarpri

Një shqiptar bile  
As për be një shqiptar  
sa për ta gjuajtur në vend të kaprojve të Sharrit

Sheshet e mëdha të Evropës  
dergjen  
nga ndjenjat njerëzore

Nën kafka të përgjumura  
të gjahtarëve të marrë

## SHTËPITË PUBLIKE TË BALLKANIT

Më në fund ateruan marsianët  
të pritur aq shumë  
nga palaçot ilirë  
Kavafisi barbarët  
në mes frashëllinjve  
zbrazin fuçitë njëqindvjeçare  
Deponojnë në bingo fatin  
dhe gjithçka që u mbet  
pas shpirtit  
Në shtëpitë publike të Ballkanit  
s'i bie në fije as CIA  
cila është kurva kryesore  
femra apo mashkulli  
Poliglotizmi i zotit tim  
do të na shpëtojë ndoshta  
nga hieroglifet e reja të shkrimkëndimit  
Shkaba braktis Flamurin  
Satrën ju lutem  
ta pres në Cung

## LLAVA

Gjysma grekë apo  
vëllehë gjysma tjetër  
Pak më shumë jevgj  
sllavë kusuri  
Një shqiptar nga Parruca  
a e bën Kombin  
Sakat edhe ai  
Ajme për ne  
Na zhbinë minjtë e shkurre



## VDEKJA E NJERIUT APO E ULLIRIT

Rrapllimë e shiut e flatrave  
Gjak Njeriu apo Ulliri  
Në shuplakën time  
Nga qiej të padukshëm nga dherat  
Mijëvjeçarët dalin cungje pavdekësie  
Përthajnë plagë buzë Ujit të Madh  
E kamishat u ndërrojnë Nënata  
Mbi kokë të gjeneral Boletinit  
Qiellin fsheh një krah sorre  
Simbol trishtimi  
Ç'ma prishi harmoninë  
Njeriun e varrosin apo Ullirin  
Mortin ta vrafsha Vlorë  
Rashë mbi një bunker dashurie shpirtrash

*Shas, korrik, 1997*

## ISHULLI ALBANIA

Këtu e në fund të ëndrrës  
ujë e ujë e ujë  
Një tokë e djegur  
Nga Zoti braktisur dhe Robi i vet  
Bregun kërkon Hijen e shpendit  
Në mes valëve të verbta  
shpëlon gjymtyrët e mavijosura  
humbet duket  
Gëlltëtës të çartur përreth  
Oh engjëlli im  
qëllomë në mes vetullave  
të më mbulojë hiri i Tokës së djegur  
Këtu e në fund të ëndrrës

*Ulqin, qershor 1997*

## ETYDË PËR SHQIPËRINË

Xhuxhe je moj  
xhuxhe je ti  
pa mua

Dhe kurrkushi jam moj  
jam kurrkushi  
pa ty

Ç'na pikuakan ëndrrat  
flatrat  
ç'na pikuakan gjak

Toka e fortë kyçur Qiella

## A DO TA SHOH SHKODRËN

Për pak nuk hyra në histori

Kisha edhe një copë udhë  
edhe pakëz frymë  
të shoh Shkodrën

Sa nuk foli Guri  
Se në fund të Pusit  
dritë e verbët e Çelësit

Mbi kulme mbi shpirtëra mbi ëndrra  
Uji i Madh  
Pasqyrë e derdhur Drinia

Male fusha ngujuar  
Sorrasorrani  
ma k'in qitur qarkun

Dhe qielli oh qielli  
Vrimë e Zezë  
gëlltit gëlltit gëlltit

A do ta shoh Shkodrën

## BETEJA E KOSOVËS

Hap syrin  
dhe nuk mundem pa klithur  
Hija e vdekjes  
ma paska mbuluar Kullën

APO

Tokë me nda nuk kam  
Hasmi në pïdh t'samës  
Me vdekë duhet mësue  
Qençe nuk jetohe më

## REVOLTA E ROKERIT TË DHEUT TË SHQIPEVE

DJALOSHI NË KËMISHË  
TË GOSTIVARIT

Arsimi i kishte 23 vjet

Kur e përjetoj Gostivarin  
djalosh nuk ishte më

Ngusht i binte çdo gjë

Qerrja hermetike e policisë  
prodhimi më i ri i mortit  
*Made in Macedonia*

Vinte nga Shkupi i përthënë

Oh Vilajeti i Errët i Kujtesës së një populli

Shenjat ishin ogurzeza

Se gjithkund frymonte Gostivari

edhe në lëkurë edhe në fjalë  
edhe në ulërimë  
edhe në lëvizje të pakontrolluara  
edhe në flakë bubullimash

Poshtëruese ishte  
gjimnastika e akullt  
nën ritmin e askushëve

Në tavernën “Arbri” në Tetovë  
një poet i sojit të rebelëve  
lidhte plagët e fjalëve qafëlejkësh

Nuk mund ia çartte imazhin Manjolës  
Prapa kafkës së Malit të borërave  
Nuk mund i shkruante  
    Se mungonte shpirti zjarri

E në pano hataje të territ  
Lulëzim Haziri  
rokeri i fundit i Iliridës  
me dhëmbë ujku qep embleme  
veshin e kafshuar të Evropës  
    Trëndafil i Zi

Bixhozxhinjtë e fateve makabre  
do bëjnë gjumë të këndshëm në ishuj vetmie  
apo ruletët do shkrepin katakombeve ballkanase



Kodrave të zhveshura shfaqen Vajtojat e Rekës  
mbi hone ato perëndi të rralla  
Britmat t'u dëgjojë  
a ka kush

23 vjet ka Arsimi

Ditën kur veshi Këmishën e Gostivarit  
të luluar në vegjën *Made in Macedonia*  
dathur e k'in parë Sharrin mbështjellë në vetëtima

Hija e mortit në Qerren hermetike  
bridhte Iliridës

Ëndërr e ligë e kishte trandur një popull

*Korrik 1997*

## SNAJPERËT

(M. N.)

Ai që ka vrrarë gjithkund në Bosnjë  
dhe në Sarajevë  
në mes nesh fshihet dhe na i mat trupat

Kini kujdes e gjurmon dhe Haga

Nga kulmet e kullave të zymta  
syri vdektar shënon  
Ai që qëlloi poetin Izet Sarajliq  
tek mbillte lulekuqen në ballkon

Zgërdhirja shtazarake prej hijalli  
shëmtuar fytyre e vrasësve të padukshëm  
gjendet në ekrane të të gjitha policive sekrete të planetit

Si morra lëkure ariu herëdokur do i qërojë  
hallakama e mikut nga Shumadia e frikshme  
emrin e të cilit nuk ia them për shkak sigurie

Se kërcënohet liria dhe e popullit serb

*1.10.1997, Prishtinë*

## PAZARI I VDEKUR

Shqiptarët  
nuk kanë zbritur  
mbyt boshllëku e nxin në Vlorë

Dhe çirruni sa të doni  
për 'i kore bukë Drinie  
për 'i kokërr kripë Ulciniumi

Nuk kanë zbritur shqiptarët

A nuk ju rrëqeth boshllëku  
fishkëllimë e tij vajtuese  
farë e zezë

Dathur Zotin e pashë  
Mbika fara dhe në Guri  
Bubullimë qiejsh ata

Paska vdekur pazari  
e gjithkund shqiptarët  
Çative të zgjuara ngrin vreri mesjetar

*Prishtinë, 1.10.1997*

## ENGJËLLI I ZI I SARAJEVËS

*Robert Elsit*

Nuk na duhet bukë zotërinj  
Nga barku i fryrë nuk frikësohet vdekja  
Asgjë nuk duam që na rëndon në Litar

Nuk na duhen as rroba zotërinj  
Vdekjen nuk mund e zbulojmë  
Nuk duam gjëkafshë ku fshihet ajo

Nuk na duhen lutje as fjalë zotërinj  
Varr të bëhemi me gazin tuaj  
Zoti ynë u verbërua duke na kërkuar Malit

Pakëz Zjarr nëse keni se ngrimë  
Në gjithçka tonën çeli hataja  
Engjëlli i zi përgjak edhe dritën në sy

*Feldafing, 29.7.1992*

## SHOFERËT E MORTTT

Ku nxitoni shoferë të vdekjes

Unë shoh kthesën që vështirë e kaloni  
Shoh engjëllin e zi që nuk mund e mundni  
Shoh çka nuk mund të vëreni nga timoni

Ku nxitoni shoferë të vdekjes

I ndieni çarjet si ju kapërdijnë vazhdimisht  
Forca si ju mashtron para cakut  
E ndieni lëvizjen si ju nxjerr jashtë veprimt

Ku nxitoni shoferë të vdekjes

Në ankth mbani botën  
dhe kohën teheve vezulluese  
që pushoi kaheër në orën time

*1978*

## MORBIDITETI

Secili xhelat i çfarëdo formati  
është i vogël  
se nuk ka  
shpirt

Ruana zot nga vidat e shoqërisë së egër  
Fuqi e djallit  
në lëvizje  
vë ato

Një shkyçje e rastit nga Sistemi Qendror  
vetëm një shkyçje e vogël  
gëzhojë mbetesh  
kreaturë morbide

## MJERIMI NJERËZOR

Edhe Qeni  
nuk kafshon  
nganjëherë  
e nuk është njeri

Po Njeriu  
nuk le gjë  
pa gëlltatur  
e nuk është qen

## APATRITËT

Njerëzit pa atdhe  
i vret gjithkush  
se nuk u duhen kujt

Njerëzit pa atdhe  
’i copë tokë qiell duan  
hiç më shumë  
Të bëjnë edhe *dekën* aty

Zoti kur i harron udhëve  
t’i mbulojnë e korbat  
t’u trembin muranat



## PERËNDIMI I KËNGËS

Ka hipur Gjeli  
majë plehut  
se nuk e zë oborri

Fort e hijshme  
na i del kënga

'i problem ka thonë  
ta zgjasë qafën  
apo t'ia thotë edhe më

Po dot të gdhijë  
Se nuk hapet qiella

Në breg të Drinit  
do e zdash  
edhe lëkurën

Sa të kaloj Ujin e Madh  
e t'u lëshoj zë  
të vdekurve të mi

## NGJITJA NË MAJË

Duhet të të vrasim  
ose na liro nga ankthi  
Nuk na lë të ngjitemi në Majë

Mes meje e Grykës së Akullit  
gumëzhinë hapësira  
nga turma e pidentifikuar

Nën dritë të një pishe  
ngjyros thonjtë një rrospi  
Seç kafshon pas qarkut

Duhet të të vrasim  
ose na liro nga hija jote  
Udhën na ke zënë e Zotin s'e shohim

Ç'gamë u zgjon të humburit e mi

## VAJI PËR TË ZONË

*Anton Çettës*

Mungon kodi  
Muri mungon në mes teje e Ujku të Çalë

Për asgjë e kurrkushët  
Atdheu monedhë e shpuar n'ajër

Mungon liria jote  
ati i Gjergjelezzalisë komitet kryeshtruar  
nga baladat epet

Vdekja ngatërron nëpër fjalë  
Në Pazar gjithë ç'patëm

Kush ngritet i pari majë gishtërinjve  
i bën të nëndhjetenëntat

Në mes gurëve  
Atdheu gjithnjë më i vogël

Në dyzen a e qitën po pika e Kullës

Nga mugëtirat e dheut e fjalëve  
ia mbledhim puplat zogut magjik

Seç vajton për të zonë i madhi zot

*Ulpianë, shtator, 1997*

## REVOLTA E ROKERIT TË DHEUT TË SHQIPEVE

Nuk u paguaka as të vdiset  
Pazarin e Grave  
cipërdoncullak e paska zhveshur Zhak Preveri  
    me stafin e tij  
    Po ku Barbara

Disa paga  
një litar për varje majë rrokaqiellit  
E guximi nga Ura e Shenjtë  
mesazh i Mulliqit në “Udhëtimin drejt të panjohurës”  
Tek shikoj Tiranën si zgjohet  
    Nga Gropat e Zeza

Në mes zotërave të rinj  
shfaqet drita hyjnore  
Përrallë a është kjo për fëmijë zoti Pound  
Se shihet preket e përjetohet  
nën zërin pushtues të Manjola Nallbanit  
Buzëqeshjen time të ftohtë i falë botës  
Kush (mund) luan koqe me një popull shtet  
Nuk e vlejka të vdiset  
Duhet paguar edhe Qerren e Zezë Mbretërore  
dy-tri metra qefin  
një pëllëmbë tokë

taksa shtetërore për gurin te koka e pafjetur  
e hijen e qiparisit  
Dënimin pse e si ke vdekur  
aksidentalisht apo në shtrat të ndonjë konteshe  
dëshminë nga policia në çfarë gjendjeje ke qenë  
dhe pse prish Projektin e infrastrukturës të Atdheut  
pastaj miqtë për heshtje e guxim intelektual  
ndonjë agjent a lavire nga planeti i kuq  
që ndez llambat në fund të mëhallës qorr  
e vadit një lule me ibrik antikiteti  
Po unë nuk jam Faik Konicë  
të siguroj patriotizmin tim ballkanik  
në një frigorifer amerikan  
Kushtuaka shtrenjtë çdo gjë  
edhe vdekja me dashje  
Më mirë t'i dal para Rrotës  
të shkëputur atje nga Grigja Botërore  
derisa Bariu bënte një sy gjumë  
në pendla shqipesh  
në firaje ohrie  
Le të dalë ku të dalë  
Gjësend nuk paguaj bile  
për shpirtin e shndërruar

në shi  
në një sy vashe  
E ajo nuk shpie në Thertore  
A vlen të vdiset

## LUFTA NË MËNYRËN HABITORE

Ka ndodhur njëfarë lufte 'i herë  
si është më zi  
Pikë e pesë engjui e perëndi  
Kush në Alaskë  
Kush në Australi  
Fara ime Sorrë dhe në Afrikë  
Fjalë të reja të moçme fjalë  
që kurrë s'do të dëgjohen  
as hapen  
në Dheun e Arbërit  
'i herë ka ndodhur njëfarë lufte  
Unë ende nuk besoj  
në djallëzi të Njeriut  
Kur Uji i Madh t'i bartë  
trupa e cungje  
dhe kur të rrjedhë i bilurt  
do të bindem ndoshta  
se lufta paska ndodhur vërtet  
në mënyrën më të poshtër



## MAL I MISTERSHËM

### GRIGJA

Më ra në qafë Ujku  
A lidhet qeni natën

Pse e lidh  
kur ulërin Mali

Më ra në qafë Ujku  
Në ëndërr më shfaqet Grigja

Pa kënduar Gjeli  
nuk çel drita

## TATËPJETË GOLGOTËS

Njerëz të gabuar  
më dënuan

Tatëpjetë Golgotës  
Ja pse luhatem në Litar

## FAMË E QYQES

Racë e truar  
kuajt taknafes

Në cak s'arrijnë kurrë  
I tmerron fundi

Famë e tyre  
flamur i zi

## TROKU MORTAR

As Shkodër as Gjakovë

Bisht i Sorrës  
fsheh  
udhë e kafka

Se shkuma na mbuloi  
deri në majë  
britme

Po Shkodra

## MAJA E HUMBUR

Fundi im nuk qenka Maja e saj

Ma fal o Zot  
edhe një jetë  
Plagë mora ku rashë

Kohë më duhet vite  
të shtjerr  
një lëkurë dhelpre

M'i fal o Zot  
edhe një palë sy  
Në Majë të saj Udha Qiellore

## HUMBJA NË OBORR

Pak fytyra  
Tepër pak  
Dhe buzëqeshje  
Mos harruam more  
Se më parë kalohet Uji i Madh  
E pastaj e pastaj  
I hyhet Pyllit  
Tepër pak  
Buzëqeshje  
Dhe fytyra

## NË FILLIM TË LOJËS

Nuk lindet përkrye nate  
pa e mbushur Grykën  
drithmë frymë  
Zjarr të ishte  
do e përjetoja edhe fundin  
Por na lexuan si Biblën  
tek zhvisheshim  
nën dritë të hënës  
e fshiheshim në pikla uji

## MAL I MISTERSHËM

Mali është afër  
Por unë kurrkund  
Humba pas Sëpatës  
T'u tregoja bile  
shtegun si dilet  
nga ky ferr dantesk  
Më afër Mali se këmisha  
Shpërtheu edhe nën lëkurë  
të dashurës sime



## PIKA E BARDHË

Nëse vritem  
më i madh jam  
se vrasësi

Ku ke parë or i uruar  
litarin nga qafa  
ta heqë i ligu

## VDEKJA

Ishe një copë akull  
Të vëja nën kokë  
kur më digjej balli  
Por me vite e vite  
Ma vodhe Zjarrin  
Më preve në besë  
Mërdhi tani  
nën flakën tënde të kaltër  
mbyllur në një klithmë njerëzore

## HAPJA E NJË POEZIE NË KOHË TRISHTIMI

### RINJOHJA

Mbasi u armiqësuan dete e njerëz  
Brigjet  
Ekzistuakan më

Pres  
të bien në dashuri  
prapë ata

Të kaloj pastaj  
Ujin e Madh  
me një lule në buzë

Do të më njohë Ajo  
Rrëzë një rrapi  
plagën e nëntë ma hapi

## BALADË PËR DASHNORIN E MADH

Nuk trupohet Gryka e Otrantos  
se i ranë patkonjtë  
Kalit të Konstandinit  
As kërcëhet më  
nga Ura e Shenjtë  
Në mes të të gjallëve  
nuk arrijnë fjalët  
Uji i Madh mundi Malin  
dhe karafilin në buzë  
ma shkrumoi hija e mallit

NUK KA GJË PA DIÇ TË SAJ

Mbështjellë në gjethë ullinjsh  
në mes zotërave zbrita

Na bëre të besojmë në fuqinë hyjnore

Një kafshë e paidentifikuar  
pa ndërprerë bren me dhëmbë parahistorikë

Dhe derisa Ti predikon mbi dashurinë  
lakuriqohet Drini i Bardhë  
në Majë Pashtrikut

Heq shpirt për një mall

Një ulkojë demonstrativisht  
braktis mitet ilire e librat  
çel në shuplakë të një bariu

Këpute nëse guxon  
Me çka ke të gurëzon

Tek ngjitet Tomorrit të purpurt  
stërpik Grigjën e hutuar

Se nuk ka gjë pa diç të saj

Në Mbretërinë e Shpirtërave  
Ndize Llampën po deshe

Deri në fund nuk na tregoi as ëndrrën

## SHPIRTI I HUMBUR

Vetëm një herë  
më zuri gjumi  
në mes gjinjve të saj  
qiellin s'e pashë më

Vetëm një herë  
trupit të saj u mbështolla  
si fluskë bore më shkriu  
aty në mbarim të lojës

Vetëm një herë  
më puthi në ballë  
Më shitoi Zanë e Malit të Prerë  
mua trimin e Arbërisë me nam

Në shuplakë të saj  
Tani pluhur zgjohem  
Frymë e t'vdekurve më shpërndan  
Kërkoj shpirtin e humbur

## HAPJA E NJË POEZIE NË KOHË TRISHTIMI

*F.*

Na përzunë nga qyteti  
Taverna hotele porta na mbyllen  
Na ndoqën forca të blinduara policia sekrete  
Tjetërku kërkoheni fatin thanë  
U përbiruar nëpër sytë ëndërrues të Naim Frashërit  
Malit të borërave i ramë poshtelart  
Me shpirtin tënd unë në shuplakë  
Ti me fyellin magjik në buzë të luluara  
Askund kasollë e perëndive të Sharrit  
Pas shumë vitesh  
nuk di cila kohë a perandori ishte  
Na gjetën në një poezi inxhi  
Dhe na thyen heshta dritare kulme  
Njëri-tjetrin tani shikojmë atje në sfond  
të zënë nga objektivi vezullues i Marubit  
Dhe dëgjojmë shiun  
Si na zgjon nga harrimi trishtues



## ËNDËRRIMTARËT

Shikohemi  
Ledhatohemi  
Pastaj kafshohemi buzëve  
Dikur lakuriqohemi deri në asht  
e digjemi shkrumb nën hënë  
Ndanë udhe mbledh hirin tonë  
një udhëtar  
Dy engjëj qiellorë  
në një shishe e mbyllin  
dhe hedhin në Ujin e Madh  
nga Kepi i Rodonit  
Ne turpërohemi  
nga gjymtyrët tona të derdhura  
Vishemi monotonshëm  
Te këmbët tona  
Waterloja tymon ende  
Dhe krejt kjo ka ndodhur ose ndodh  
përmes shikimit të dyshimtë  
në mes një perrie  
e kaçaku të dalë nga zgura  
me një gjarpër ndër dhëmbë

HANA

Fushave maleve tërë vaj  
Oj oi oi  
Qëlluar e ka aty  
ku fikur më ka mua Oj oi oi  
Një nga një zdeshte teshat  
valës Drinit  
ia hidhte  
Oj oi oi  
Dal para na i kish 'i cub me fletë  
Aty ku pran dhembja  
sosur e kish  
Lumja û  
Mblidhte flokët gardhiçeve  
obobooo

## ODË HYJNIE

Vashat nuk m'i lexojnë më poezitë  
nuk cullakohet kush në to  
As micsokolat t'i hapin nën dritë vetëtimash  
pak krismë dëgjohen bregut të Drinit  
Nëpër gishta të mi të harruar mbi dhe  
brek të luluara thajnë flokë të gjata  
trupa të djerësitur buzë të kafshuara  
lëkura dhelprash ujqish gjarpërinjsh  
gjerdana prej ari të mjeshtërve shkodranë  
ngjesh e vesh me margaritarë arabie  
Tërë sysh çartur rokerët e pagjumë  
pyllit të fjalëve të mia zbresin  
në një bunker skaj planetit të ndezur  
e pinë për shpirtin tim

## ATY KU NUK ËSHTË MË

### ZOT A MË SHEH KUND

Gjysmën e Zvicrës e fshiva  
Kur të fshij dhe gjysmën tjetër  
do kthehem në Kosovë  
Qysh e si as vetë nuk e di  
Oh zot  
A më sheh kund

*Cyrib, dhjetor, 1997*

## DINOSAURI MODERN

Ngris perden  
Dhe shiko shiko Çudia e zotit  
Evropa bukuri prej gjarpri  
Në shtrat puplash ëndrrash  
majë pas majë zgataraget e ec e ec e ec  
Diku në Kosovë në midis oborrit  
rreth një huri të gardhit të derdhur  
për bisht e lidh këtë dinozaur modern  
e humb labirinteve të madhështisë

*Cyrih, 15 dhjetor, 1997*

## BOSTADEL

Bostadelin nuk do ta harroj dot  
Vetëm aty nuk më lejuan  
të kem mbrëmje letrare  
edhe pse gjuhë e parë *shqipja*  
Grilave të dritareve të mjegulluara  
kacavareshin fjalë të përziera  
me pikla shiu  
Nuk desha t'i ngujoj në një poezi burgu  
Të mbyllura ishin edhe ashtu  
Ndjeja dhembje për gjuhën time  
Se qart lexoheshin sytë e shkruar të ëndrrës

*Zug, 17 dhjetor, 1997*

VAJI I NJË SHQIPTAREJE QË  
E SHËNOVA DIKU NË EVROPË

Në Taphane atje kush rren  
se Evropa nuk kujdeset për ne robërit  
Aq gjentile është  
sa nuk eksperimenton gjë pa ne  
Në Spitalin e Madh Psikiatrik rekomandojnë  
vazhdimisht

Çdo mbrëmje nga *Tolvan*  
Të duket më e bukur  
Jeta prej robi  
e hiçit

*Notwil, 17 dhjetor, 1997*

## ATY KU NUK ËSHTE MË

Të gjithëve na mungon  
ngapak Kosova  
Unë e shoh aty  
ku nuk është më  
Fundi me hajr qoftë  
Gjendemi në një hapësirë nevrrike  
ku humbim ose fitojmë të gjithë

*Basel, dhjetor, 1997*



## ZOTI I LAKURIQUAR

*Edi Ramës*

As në Pyll  
nuk është më vetëm Njeriu  
Shtohen cungjet gjithfarë formash

Nuk di a ka nevojë më  
për përsosjen e tyre  
nga dorë e Mjeshtrit

Pylli rrallohet  
se Njeriu kërkon të jetë zot i lakuriquar  
ose t'i ngjajë pakëz atij

Të shoh Evën  
kur bie në Krua *tetë sylynjarësh*  
për të pirë ujë

*Këln, 1994*

GRI

Kur të vdes  
Varrosmëni ku të doni  
Stom një burimi  
apo nën sjetull të një Mali  
Vetëm ku flitet *Shqipja*  
Me perëndi të flas  
edhe përsëvdekuri  
tërë kohën e vdekur

## ARTI I VDEKJES

As jahudia nuk e gjet tërfilin  
me katër fletë por në ëndërr  
e kish parë një gjakovar

Ja sa nuk ka kthyer nga Shkretëtira

Vite e vite e vite  
e nuk pran Makinë e Qenit  
Vetëm vdekja qenka e përkryer



# PIKË E ZEZË NË BLU

Onufri, Tiranë, 2005



## BIBLIKE

Mjerimi të lë  
Pa u larë  
Majës derdhet kanalizimi

Nuk vidhet atDheu  
As vritet  
Luftëtari i tij

Në tokën tënde  
të çosh jetë refugjati  
mallkim gjaku

Engjëlli im  
vëma dorën mbi ballë  
të ndiej veten

A jetoj

*Bllacë-Mumib, 1999*

## IMAZH I AKULLT

### NJË I VDEKUR I ZAKONSHËM

Një i vdekur i zakonshëm  
në këmbë mban një shtet  
Vrapon shkallëve thyen dritare  
Mbledh dhe pikën e fundit të ujit  
Mbi tryezë bie galuc  
nën dritën e llambës  
Një i vdekur i zakonshëm  
Dhunues e vrasës bezdisës  
I ndjekur e i vrarë vazhdimisht  
Shpallet publikisht prishës rendi  
Në ballkonin e hapur kah qielli  
Një vashë e lakuriquar  
Ngacmon moralin qytetar  
Delja livadhut shëtit Njeriun  
I lumtur se jeton thotë  
i Gjithëpushtetshmi  
Një i vdekur i zakonshëm

2000



## GJYSMËFOTOGRAFIA

*E. Sabatos*

Mbi arkë të vjetër molla në pjatë  
Thika nga antikiteti pranë  
Shandani epirotas në fund dhome

Zotëria nga Buenos-Airesi  
Pasqyrat e dritave kishte thyer  
Veten nuk e shihte tamam

Se ka Shqipëri edhe tej Drinit  
Nuk deshën ta pikëllojnë  
Tiranasi

As librat e pagjumësisë s'i shfletoi  
Nuk ishte zgjuar ende nga ëndrra  
Në fjalë diku i kurthuar

Mund ta rrokulliste çelësin  
Vijën e kuqe ta kapërcente  
Në Dardani të lexonte dhe gjysmën tjetër të fotografisë

Luli i Lalës  
Shoqin nuk e ka  
Në kohë bubullimash

*1995*

## LEKURË PËR NJË DAULLE

Hap shuplakën mbi hapësirën e zymtë  
Kaq mbet lavdia  
E sheh ky gisht ka mbuluar  
Krojet e Ali Pashë Gucisë, ai Dolin  
Fundi i gishtit tregues  
    Limin Vrujen Nokshiqin  
Pak në të djathtë nuk di a i sheh  
    Rrjedh Bistrica  
    pastaj ai lumthi i miteve  
    brenda dite shfaqet e humbet  
    nga një varr i paemër  
Ndërsa në pjesën e sipërme të shuplakës  
    majat kullat grykat  
    që po i kërkon nëpër fjalë e libra  
    tutje vija e zezë që na ndan  
    nga fluturimi i lirë i shkabës  
Dhe bari i egër mbi çdo gjë të gjallë  
Vlen lëkura për një daulle?

*Guci, 1992*

## HIJA E KODIT TË MALEVE

Kumbarinë do e mbajmë  
Të qetë a na lë gjaku  
Po gjaku derdhur përdua  
Të vdekurit k'in zënë pastaj  
Njëri-tjetrin ta kërkojnë  
Hije të mos u bëjë kobi

*Mirditë, 2004*

## NËNA ZBRET NË ZEMËR TË DHEUT

Nëna kaloi Erenikun dyll e verdhë  
mes të urtëve u shpërngul  
Për çati ka një re

Me vete mori dhe të vërtetën  
për mua kur pashë për herë të parë  
ylberin mbi Çabrat

Edhe fjalën e fundit kur ma tha  
gabim i identitetit si hije më ndjek  
e unë zihem me ligj

Nga betimi i nënës nuk çohet dorë  
Mbi çdo pushtet ajo  
Madhësisë së saj i përulem

Me një qiri në dorë e kërkoj  
por mbretërinë e saj  
Në breg të Erenikut e fsheh 'i selvi

*Munib, 1998*

## ORË E TYNZOT

*M. Zeqos*

Nikollë Marku  
Mbrojtës i fundit  
i Autoqefalisë së Elbasanit

e tha edhe këtë

Ai që vdes për atDhe  
vetë Zoti  
e kërkon

Po ku do më gjejë mua  
në cilin varr  
a planet  
tejt shtatë qiejve

Nikollë Marku  
i Atit i Dheut i atDheut  
Orë e tynzot

Qoftë lavduar

*Elbasan, 15 mars 1999*

## ZGJIMI

gjumë gjumë gjumë  
nuk ka më  
gjumë

vërshon një lumë

gjumë gjumë  
gjumë  
gjuuu më

edhe një sy

me britma e thika  
na zgjojnë

çarçafë të bardhë  
na hedhin  
perënditë e Sharrit

imazh i akullt

nuk ka më gjumë  
gjuu më  
nuk ka mëëë

as ëndrra

*Tetovë, 1999*

## KARASINANPASHA

E zëri tej mureve të gjalla

Kosova deri kur të merret me Serbinë

Serbia do lirohet nga Kosova

Do ndërhyjnë forcat e NATO-s

Serbia krahinë e Vilajetit të Errët Pashallëk

Votohet për karasinanpashën

Të bëhet më parë synet

*1994*



## EKLIPSI

As kjo ditë pa kordel  
Dhe kjo natë  
Pa hënë E Kosova

Nuk na zë hapësira  
Ç'duhet kjo bimë ulërihet  
Vetveten kur e zhbijnë

As ky mot pa zjarre  
Tatëpjetës guri djersin  
I ngatërrohet shqipes fluturimi

Në të zeza shfaqet dielli  
Herr e err gjaku  
Po Kosova

Shumohemi ne apo vdekja

## DRENICA

Gjumë në sy nuk futëm tërë natën  
Ajo duke kërkuar vend për të më shtruar  
Unë duke ia mbuluar plagët

Kullat 'in shndërruar në varre  
Në hone përrallash të fundshekullit

Fëmijë të vdekur linden  
Nënat flasin me shpirtra me engjëj  
Flasin me perëndi

Vit për vit bëjnë nga një luftë burrat  
Tej horizontit ndjekin Ujkun e Çalë

Unë kam problem me kujtesën me pagjumësinë  
Nuk mund ta gjej shtëpinë e mikut  
E kaq shpesh kam dalë në Drenicë

Asgjë nuk është në vendin e vet  
Edhe varret kanë lëvizur

Thonë se atë e kanë marrë me vete  
Azemët Ademët kapedanët  
Fshehur e kanë dikur nga thika e hasmit  
derisa të rriten fëmijët

Unë bredh fjalëve baladave ëndrrave  
Nuk lënë korbata ta shoh qiellin  
Në vetëtima e ngujuar rri Ajo

*Drenicë, 1998*

## LITARI I ANKTHIT

E lirë Kosova dhe e pavarur  
Me një litar rreth qafe  
Kërkon degën më të lartë

Si dele nuk i dilet në pazar  
Nëpër fjalë seç dridhet  
Midis dy qytetërimeve e zënë

Nuk e mban litari as e lëshon  
Në konferenca ndërkombëtare  
Kallëzohet si përrallë

E s'e lëshon as e mban një litar

*Ulpianë, 9.10.2000*

## SHQIPËRITË

*Dr. Pandeli Çinës*

Na tmerruan shqipëritë  
Edhe tej e tej e tej  
Varre e nishana pikëllues

Në ëndrra pikëlojnë sy  
Një asnjëherë o perëndi  
Të ketë 'i kërthizë guri

Të dridhen tokeqiell  
Kur të dëgjohet në log  
At e bir e i shenjtë të betohen  
nadjembrëmje

Na bënë pikë e pesë shqipëritë  
Nuk dimë ku e bëjmë vdekjen  
Vaji na është këngë

Frymë bëhemi e nga 'i grusht dhé  
Duke i kërkuar të uruarat  
Nëpër harta tragjike

*Tiranë, nëntor 2001*

## HIRI I SHKËLQIMIT

Kep i lartë e i ndritshëm  
Humbet nën hijen e perëndive  
Qiellit tënd një shpend  
    krahët nuk i rreh  
Poshtelartë syzgurdulluar  
i bie madhështisë së derdhur  
të gjej dot Itakën dhe ndiej  
nën këmbë si ma ha dheun  
    Miu i Shkurrës  
Tek më mbulon fundekrye  
    Hiri i shkëlqimit

## LIBRI I PAKRYER

E kishte shikuar orën  
gjumë të thellë  
bënte një popull

Prapë e kishte shikuar  
dhe hedhur e kishte  
nuk kishte më kohë

Libri ishte mbyllur  
po kujtesa  
a harron?

*Munib, 2000*

## MARATONI NGA ILIRIA

### 23 SHKURTI

Tërë ditën  
Ditën e 23 shkurtit  
Rrobat më të shkurtra ndoshta  
Për ditëlindjen e pesëmbëdhjetë  
Bankënotën e fundit Petritit  
Në Murin e Kujtesës edhe një gërvishtje  
Konferenca e Rambujesë i takon të kaluarës apo  
Flini të rënët e mi  
Ka me u zgjue zëri i Dheut  
Jashtë rrethit të vdekjes  
Petriti fillon të 16-tat nesër  
Unë vazhdoj të grindem me zotëra  
Ç'ditë e shkurtër  
Më e shkurtër se shkurtkeqja

*Ulqianë, 23 shkurt 1999*



## LIQENI NË MAJË

Udhës i paska rënë syri një trimi  
As e dashura nuk mund t'ia gjejë  
Tek paska pi ujë e la plagët  
Qenka shikuar një kaproll në të  
Bukuri e tij mahnitur e paska  
T'i bëjë dritë varur e paska në bri  
Lëviz tokeqiell e shikoni majës së lartë  
Dridhet nga të prekurit ushtinë  
Ka frikë ta shpalosë edhe më  
Hijes së të zotit i ruhet zjarrit  
Përplaset brenda vetes dhera spërkat  
Vërdallet i ngujuar pyllit kalli vetëm  
Liria një pëlqik e derdhen brigje  
Në bri të kaprollit vezullima shastis  
Nuk pushon e dashura së lotuari  
Trimit kush mund t'ia gjejë syrin  
Kanoset vërshima e kaprolli s'qëllohet

*Shtarnberg, 15.1.2000*

## NË XHAMIN E ERRËT IMAZH I SË NESËRMES

*Fitore Podrimjes*

e bukura veshur kish rrobat për mejdan  
këmishë qëndisur nga gjuhët e flakës  
rreth qafe m’i kishte hedhur duart plot dhë e rrënjë  
seç pëshpëriste lutje të moçme majë klithmave  
Mali i Borërave hijonte mbi shpirtra  
nën një dru mijëvjeçar thithja gishtërinjtë  
tek kapërcente bjeshkë zjarre ujëra  
    kapsoll syri im i tretë  
gjallë a dekë të takoheshim i lutesha të madhit  
nuk mund të ekzistoj pa të as pa mua ajo  
mes trupave lëshonte shtat e nesërmja  
nën një çati të Iliridës zog i qiejve  
    më kishte zgjuar  
kur trupin e saj ia kishte mbështjellë tymi  
rrobat e mejdanit a i rrinë mirë  
me sa lule qëndisur këmisha nga gjuhët e flakës  
të thara buzët e tej Malit të Borërave  
frymon Kosova e frikshme dhe e bukur  
vezullimë e verbër kish shkrepur e në xhamin  
e errët imazh i së nesërmes vijëzohej  
na duhen lotët edhe për gëzim grua e dashur

*Tetovë, 30.3.1999*

## NUK ZGJOHET DRANJA E MARTINIT

Nën ritmin e organove  
rishfaqet e perënduara  
Dridhje fjalësh lutjesh gjuhësh  
Kapje detajesh figurash lëvizjesh  
laramani kostumesh  
Elegancën e Dranjës së Martin Camajt  
nuk e ka kush  
Pikërisht në orën 12 kalorësi e vdekur  
Pushton Marienplaztin  
Për pak kohë heshtja ngulfat  
Prajnë aparatet dhe gjuhët  
Të gjallët kurdisin orët  
kur të kthehen në kohën e tyre  
Mbi kulla gri dhe ndonjë pëllumb  
Një ëndërr të keqe unë shkund  
Zë trenin Munihi-Feldafing  
Dhe vazhdoj të lexoj “Dranjen”  
Në kopshtin Zoologjik truku elektronik  
thonë se ndikon në kujtesë  
Nën ritmin e organove  
nuk zgjohet Dranja e Martin Camajt

as s'e pa kush në Marienplatzin  
se tërbohet se ka turp prej të Zot  
të rënë nga Temali

*Munih, nëntor 1999*

## BALADË

*Skënder Zariqit*

SZ kishte parë në ëndërr vendin  
ku nuk vdiset  
vemi e dashur

Ajo vetëm kishte pëshpëritur  
do e mundim edhe vdekjen

Dhe kishin udhëtuar e udhëtuar e udhëtuar  
e kishin arritur në atëfarë vendi  
ku nuk vdiset

Kishin dëgjuar pastaj kallëzime më fantastike  
për qiell e tokë e ujë

Një mesditë SZ e kishin përcjellë  
në udhëtimin e tij të fundit  
As në ëndërr nuk ia kisha parë vdekjen

Në hënë ishte shndërruar vasha  
te guri i të dashurit

*Ulpianë, 2001*

## FËMIJËT E VDEKJES

U vranë e u shanë pse u vranë  
ditën për hënë  
Stepës qark fëmijët e vdekjes  
Nën vezullimë tehu 'i mal bin  
nga 'i rrënjë parahistorike  
Gjarpërinjtë ndërrojnë lëkurë  
Qark stepës terrinë e Ujit të Madh  
Zhduken duken fëmijët e vdekjes

*Çabër, mars 2004*

## FUSHA E ZEZË

Ku të lëshoj rrënjë  
e të bëj pakëz hije  
se varre e varre e varre  
mbi to zgjohemi e dashur  
shkundi dritën e verbër  
të lexojmë fundin e ëndrrës  
nën një qiparis

*2005*

## TEK PIKASJA NGJYRËN TIME

Shtriva mbretërinë tej shikimit  
Dhe në Kepin e Vetmisë  
Ngjyrën time tek pikasja  
Desh më shkuli Uji i Madh  
Të mos e kafshoja në vesh Zotin

*1999*



## MARATONI NGA ILIRIA

Është një engjell që na mbron  
Se kujt Maratoni nga Iliria  
Do ia kumtojë lajmin  
    se në Ulpianë  
    u gjet tërfili me katër fletë

*1999*

## MES UJIT TË MADH DHE ËNDRRËS

### ULCINIUMI

Syth mes Ujit të Madh dhe Ëndrrës  
Nuk ke ç't'i marrësh as t'i lësh  
Ullishtës ilire ikën ora e një populli  
Nën këmbë lëviz e vdekura  
Në dorë të Zotit  
Në Barbanë bie Shqipja  
          sytë i lan nga bloza e kohërave  
Dhe me njërin krah mbulon  
          trupin e përgjakur të Gjergjelezhalisë  
Buçimës ia ka frikën dhe shkëmbi

*Ulqin, qershor 2005*

## PUSHTIMI I FUNDIT I LABEATËVE

pushtimi i fundit i labeatëve  
ndodhi në gusht të vitit 2005  
kur kopicën ia vunë Rumisë  
një fëmijë tek zbriste nga lartësitë  
ilire kishte shënuar në faqe guri  
për atdhe nuk vdiset më por për kurva  
në gjunj kishte rënë te një rrap  
më dysh i çarë nga rrufeja  
dhe kishte pirë qumësht ujkonje

*Ulqin, gusht 2005*

## VORBULLA

*R. Ushakut*

Vringëlloi Shpata e Gjergjit  
likpërmjet Uji i Madh  
dhe më rrëmbeu vorbulla

Larg Bregu e fundin  
preku lemba e derdhur  
Qyqekall isha me vetveten

Nuk kisha hutë as bori  
lëvizjen mortore t'ia ndërroj  
kepave t'i zgjoj hyritë

Me vite zogu sykuq përcjell  
haklitjet e mia por  
fluturimi pikë kritike

Uliks djerrakohës mbeta  
tek kërktoj Itakën time  
brenda 'i lëkure të trishtë tigr

Sapo humbas ndjenjat e të qenmit  
Uji i vdekjes më stërpik  
Hënë e zezë maskë e të Premtes

*Ulqianë, 2005*

## THIKA

Në pikë të zezë  
u shndërrua thika  
midis dite

Skajet ç'm'i mori Evropa  
lakmi t'i ketë  
dhe kasapi me nam

Vetëtimë e tehut  
verboi perënditë  
e malit tim të shenjtë

Qiej e qiej  
Seç shplohen  
Nga plagë e hone

Rrëzë një rrapi  
shoh si çel trëndafili  
nga trupi im i gozhduar

Nuk i merret erë  
as këputet  
Të gllabëron pikë e zezë

*Ulpianë, 2005*

## VARREZAT E KALTRA

Majë dheut  
me diell matnin kohën  
trembnin xhindet me një lule

Kur ia shihnin vdekjes shpinën  
ia luanin edhe fatit

Nga mërzia e Dheut e Shkëmbit  
nga terri i ujërave dilnin se  
pak tokë për bimë për frymë

Nën krah të pulëbardhave  
i merrnin ngryk perënditë  
Varrezat e kaltra trishtim shqiptar

Symbylltas shkilin  
fundin e ëndrrës  
Te Grykë e Otrantos

Ngryset apo gdhin

*Ulpianë, 9 janar 2004*

## IMAZH PIKËLLUES

*Bashkim Kuçukut*

Kur nëna i vdes çamit  
erërat prajnë dallgët  
prajnë telefonat kujet

troku diku në balada

Perënditë majave të Sulit  
Veshur në të bardha  
flasin përmes lëvizjeve

Çamit kur i vdes nëna  
Harrimi ku fillon e ku Çamëria

Nga thellësitë zgjohet deti  
me një shall blu  
ngjitet zbathur te perënditë

Një degë ulliri  
sa çil e mbyll sytë  
fsheh imazhin pikëllues

Bukuri që të bën të qash

*Shkurt, 2005*



## MURI I PADUKSHËM

Ngritet muri i padukshëm  
Ma kthen kokën si top llastiku  
E kokëfortësia ime ta mund

Zhvesh fjalët para flakëve  
Gishtërinjve më kacavaren  
Nga 'i valë ua var qafëgjatave

E pak kaltri të Lumit tim

Në hone të 'i labirinti njerëzor  
'i çelës i artë humbet  
E luhatem në perin e merimangës  
unë banori i fundit i atlantidës

Në të djathtë në të majtë  
shoh vetëm njërën faqe të diellit  
hija e murit fsheh tjetrën

E kokëfortësia ime ta derdh

*Ulpianë, 2005*

DO VIJË KOHA IME PO S'DO JEM UNË

Çdo ditë çdo mot pikon një çati

Hëna kur rrokulliset shpatijeve  
në horizontin gri duket 'i njeri  
dush bën nën qiellin e hapët

Kaçurrelat plot pluhur i kreh  
para një pasqyre të harruar  
të shtojzovalleve të Drinisë

Palon Planetin Ka-ka dhe e hedh  
në një kontejner të shekullit XX  
Do vijë koha ime po s'do jem unë

Një çati pikon çdo mot çdo ditë

*Ulpianë, 2005*

## LEHJE ATJE POSHTË

U ka dalë zëri  
Heronj apo brejtës  
Zëri u ka dalë zoti im

Kur nata bie mbi Kullë  
Vë veshin në frengji  
Dhe përgjoj terrin

Nuk është shenjë e mirë  
Të lehurit atje poshtë  
Zëri u ka dalë zoti im

*Ulqin, gusht 2004*

## MËRZIA E DHEUT

Shqipet fluturojnë nganjëherë  
dhe ulët

Nuk ka kush ua hap qiejt  
Mbi krahë u rëndon mërzia e dheut

*Ulqin, qershor 2004*

## PIKË E ZEZË NË BLU

### PALAÇOJA

Fik flakën gëlltitës i zjarreve  
Në amfiteatrin kombëtar  
Edhe një vrap në litarin e vdekjes

Tamtamët menë po ç'ka tej  
Kohë e panjohur a valë e vdekshme  
Tund planetin njerëzor

Boshllëku pushton dhe Majën  
Të trishta shkallët në ajër  
Dhe karriget e shkapërderdhura

Publiku? Ajo qeshje e ngrirë  
Drithmë gjymtyrësh drejtpeshimi  
Çdo gjë në zgripç dhe fjalët

Grimcohesh përtyresh villesh  
S'e ndien veten as i kap hieroglifet  
e të nemurve atje tek rrënja

Mes magjisë e mashtrimit  
Muri i Vdekjes

Udhën qumështore tehu fsheh  
Rrjedh 'i plagë e s'e le njolla të mbyllet  
Palaço i shkalluar nuhatës i erërave

*Ulpianë, 2004*



## KOHË E TË QESHURIT

Qeshemi se na qeshet  
Dhe mësohemi të qeshemi  
kur s'na qesh mbreti

Të qeshet është koha  
Dhe pse të mos qeshemi  
Dhiehemi e hamë sa do zoti

Murmurimë kur dëgjohen tej  
Nëpër fjalë lëviz muri  
Ditenatë bien kambanat

Nga hija e dudit të egër  
Nuk shihet pajtoni i zi  
Sokaqeve tekërliset në gjumë

Qeshemi se jemi çfarë jemi  
Nuk na shpëton as miza  
Mbreti shakaxhi doli por

Ç'do bënim pa të o perëndi  
Një dhëmb ujku ju lutem  
Mësysh të mos i bjerë kush

*Ulbianë, tetor 2004*



## BASTARDI

Plehu e pa veten lule  
në një kopsht përrallor  
me basen plot kërmij

Majë një Rrote tek sillej  
Karriges së praruar prej hëne  
Qirinj të fikur

Buzëthithur 'i rrospie te koka  
Se Gjylestanja e virgjër shkruante  
Memoaret e Hodumagës  
nën çatinë prej qielli çiqërr

Turma seç ia prishi gjumin  
në nevojtove ballkanike  
veten e kishte parë pleh

*Ulþianë, 2004*

## I MARRI I SOKAQEVE TONA

Në kasabanë tonë askush s'e di nga kishte zbritur por  
Ai do u thotë madje pandërprerë do u thotë tërë kohën  
Se numëron kometat dhe nuk ka kohë t'ia  
kallzojë dhëmbët asaj as origjinën  
Do u flasë tevona për një kravatë të blerë diku  
në një lagje të Evropës e që i  
ndrit ngjyra e verdhë dhe kush s'e di pse  
bie e zgjohet me të  
Sokaqeve letrare do ligjërojë për nocione e shkolla  
bile dhe për aristokracinë letrare  
prapë do e zë ngoje kravatën e blerë  
diku në periferi të Evropës  
në të, thotë, do jap shpirt po qe se kohët barbare  
trokasin në portat e kasabasë  
vdekjen e tij nuk e pranon të mos jetë  
më e bukur se ajo e Sefë Koshares  
Ai do u thotë madje pandërprerë do u thotë tërë kohën  
se në ishullin sh e kishte syrgjynosur flokëverdhi  
mundësi i të gjitha lëneshave e rrufeve  
do u bezdisë pastaj për të gjitha të zezat  
e përjetuara në kreshta të zhveshura

por nuk bën të çuditëni se në fjalorin e tij  
     ka më shumë sh se shkronja të tjera  
 se çdo gjë e tij fillon me germën sh  
 Ai do u thotë madje pandërprerë do u thotë tërë kohën  
 se dëshiron të lirohet nga fuqia e demonit  
 dhe aty në ranishtë i shkruan emrat e kapuçonëve  
     që ia kishin gropuar ëndrrat dhe rrëmbyer  
 edhe kravatën e verdhë ku e shihte fytyrën e vdekjes së vet  
     më të bukur se të Sefë Koshares  
 Në Majën e Mjegulluar e shikoni ngjitet para se  
     valë e tmerrshme ta shkundullojë n'sa  
     diku në një çati të kasabasë hija e tij e varur  
         në cohën e verdhë luhatet  
 por kush k na ishte do dëgjohet më vonë  
 dhe pse Policia ndërkombëtare hoqi dorë nga  
         besimi i tij  
 Ka kohë që i marri i sokaqeve letrare nuk na kallëzon më  
         as ëndrrat  
 Në një gozhdë të ndryshkur thonë se teja  
         ia hëngër fjalët dhe gjuhën  
 Dhe memecllëku i tij na shpëtoi nga zhurma e veshëve  
 mbi një varr të gjallë  
 Gjurmë i rëndë kishte pllakosur kasabanë

*Ulpianë, 2005*

## PIKË E ZEZË NË BLU

Ia pren' edhe degën e fundit  
Bishtin ku do e lidhë  
Çakall i mjerë

Humbi orientimin  
Nga të dilet  
Gur i turpit rëndon

Rënie e tmerrshme  
Në cirkun nacional se  
Lartësia pikë e zezë në blu

Çakall i mjerë

*2004*

## KUR SHEH ËNDËRR QENI

kish parë ëndërr qeni  
se ishte më i madh  
se hija e vet dhe i ziu  
veten kafshuar kish

shi tri ditë e tri net  
larë nuk e kish gjakun  
mal e fushë vërshuar e kep  
fushë e mal mortja kaluar

qeni kish kafshuar veten  
më të madh se hijen  
parë e kish dhe shtatë ditë  
e shtatë net diell as hënë  
ndrit s'kish

## PËRMENDORJA E VIÇIT

Viçi ynë më në fund  
Meriton një përmendore  
Kasabanë na hijeshon

Do e puthni e shastrisni  
Në shesh diku të Nënës Terezë  
I bukur e përrallor

Dhe pse të mos e kemi  
Kur Evropa ka përmendore  
dhe për mikimaus e qen

Dhe pse zoti President  
Para Teatrit Kombëtar  
Pëllëmbë toke nuk e ndani për viçin tonë

Nëse ngrihet ndonjëherë  
Mjeshtrit me nam i kërkoni  
Gjuhën t'ia lënë përjashta

Na shurdhoptë i pagoji  
Me rrënjë ia shkullim  
E bëjmë gjumë të rehatshëm

Mes gjinjve të një rrospie

*Maj, 2000*

## ZEROT

Rrokullisen zerot  
brenda vetes shumohen  
e përplasen kometa të shuara

Nuk pipëtojnë as shihen  
zero me zero udhëtojnë  
fuqi e padukshme i lëviz

Syqiklop ky boshllëk  
kapërdin e vjell tmerr  
hije të ngrira përreth

Turr majeve ku është Zoti  
Planet i mistershëm atDheu  
mbi kokë hënë e zezë

Ageterr frymë morti i rrah  
me dry harrese kyçen  
Zerot në zero zezohen

*Ulpianë, 2004*



## BREGU JA ERRET

### UNIVERSI I PIKËS

Lehtë ta kalosh detin  
Provo pikën e ujit  
Të duhen vite ta mundësh  
Pikën provo atlet  
Ujërat shteren në sy të perrisë  
Thatësi e zezë na përthau  
As fjalët as ëndrrat  
Ta lëvizin dot gurin  
Ke pasë kaluar dete  
E ke pasë lënë nam  
Pikën e munde atlet  
Në Urë të Shenjtë të dukesh  
Mbi vetull të perrisë  
Ta harruam edhe hijen  
Koha prapë nga zeroja

## SHKET NJË LIBURNË

Ujërave të Arbërisë shket një liburnë  
Hyrie as përbindsh kahjen t'ia ndërrojne  
Hijerëndë shket se vjen nga lashtësia  
Moleve të vetmuara zbresin udhëtarë  
Me nga një valixhe flamur majë shtize  
Çilen porta të padukshme e kuje dëgjohen  
Ndërrohen pasqyra e hidhen çelësa tej harrimit  
Një i panjohur i quajtur Servantes  
    nuk dihet si ishte gjetur mes atyre shpirtrave  
    dhe kur e kishte lëshuar liburnën  
Në plazhin e Nudistëve derisa ishte parë  
Tek rrëfente për heronjtë e vet ishte zhdukur pa gjurmë  
Në katakombe të Ulciniumit thonë e k'in ngujuar  
Ishte alarmuar Evropa dhe Interpoli njoftonte:  
    të veshura ka pantallona xhins  
    një vath lashtësie në veshin e majtë  
    me geld të firmave evropiane  
    të lyera flokët  
    dhuratë blanën nga një adoleshente ngjyrëbakri  
    në shalat e saj kur rrëshqiste  
Shket një liburnë e Kapiteni përtyt fjalë i copëton

Nuk dihet kur do na thotë mesazhin më të ri  
Flamurin a do e ngulin dhe çfarë do hapin nga valixhet  
Të përhënë të shfaqen para portave  
ku në kohë merimangash?

*Durrës, prill 2005*

## NË MBRETËRINË BLU

Ndore të Bindit  
Kullën e Balshajve braktisa  
’i hyrie pusi i zura ku puqen kodrafusha  
po detit nuk mund ia luajta  
Në një guaskë lashtësie te Buna  
Majë gishtërinjve në rroba blu afrohej ajo  
Sa pika kur mbet në shuplakën time  
Mes gjinjve zjarmie e hodha  
    Përcillja rrugëtimin e pikës  
    derisa rrëshqiti trupit të valëzuar  
Deti nuk shihej  
    as shihesha unë  
    dheraqiej çuar peshë rreth Rumie  
    honit ikur ’i katalla  
Në Kullë të Balshajve ta ngujoja zoti im  
    E t’i ngjallte stuhitë e gurëzuara  
    Kalistrok me hyrien ikte deti nga unë  
    Në mbretërinë e rrënjëve te shpirtrat  
                                    kandila blu  
Dalë më kishte besa dhe ’i copë udhë kisha  
Më kërkonte Bindi dherave të Arbërisë

*Ulqin, qershor 2004*





## CUNAMI NËN ÇARÇAF

Temperatura e trupave paralajmëronte vërshim  
Planeti majë një gjiri mllëfi  
përcillte ndërrimin e peizazhit  
si shkuleshin lisa e hije e  
gishtërinjtë rrënjë rrafi  
mbështillnin një hyrie deti  
    të nxjerrë në breg nga valët e tërbuara  
    skaj nate sy i hapur peshku pipëtinte  
    mund të strehohen taborre  
Ishin shfaqur gjarpërinj parahistorikë  
e laguna e vdekur tej shikimit  
as valë e tërbuar të bëjë gjë  
    Rrëshqitnin gishtërinjtë  
    rreth trupit të lakuriquar të hyrisë  
Kishte ndodhur kiamet i madh  
    Përjetim i tmerrit në Ballkan  
    Një i verbër mbliidhte lot e shpirtra  
Por mjaftonte një çarçaf i bardhë  
    të fshehte dhëmbët në trupat qumështorë  
    në zgurë të shpërnguleshin dhe varret  
    dhe të shikonin horizontin si zgjohej  
pas shirave e vapës tropikale

*Ulqin, qershor 2005*

## PËRFLAKJA E TRUPAVE

Ne ishim krejtësisht të verbër  
kur buzë e trupa na u përflakën  
Me prekjet tona vizatonim ëndrrën  
Në mes udhës pëshpërit ajo  
Minuti pakëz një jetë  
Të mos hapej kurrë ashensori.  
Por lumturia tepër e shkurtër  
Në mbarim të udhëtimit  
kur drita na kishte zbuluar  
Ne ishim krejtësisht të huaj  
Buzë e trupa na kishin mbetur diku

*Mars, 1999*



## ZOTI NUK ËSHTË MACE

Zoti nuk është mace  
të na grithë rreth qafe  
Na hedh nganjëherë edhe  
Tej Lumit të Verdhë ku  
Shndërrohemi në pluhur  
E një stërkeqe na shpërndan  
dherave të shpopulluara  
Zoti nuk është mace  
As dashuria të plaket

## BREGU JA ERRET

Përfytyrova gjymtyrët e derdhura të atDheut  
të Atit të Nënës të Shenjtit  
Varreza mure çati të nxira  
Çerdhe lejleku në oxhaqe të kacavarura në ajër  
Burrërisë së tij iu përula  
dhe për trimërinë e fyer më pikoi loti  
Shava zot e shtet e kod se  
ndëshkueka edhe liria, ja erret Bregu  
ku pres fundin tim me një karafil në buzë

*Ulpianë, 2005*

## TË BUZËQESH MORTJA IME

Më rri në distancë  
në mbarim të lojës fshihesh

Heshtja ime e tmerrshme  
se zjarri yt i akullt

Në distancë më rri  
të buzëqesh mortja ime

*Ulpianë, 2005*

## UDHËTIMI NËPËR PYLL

Kujdes se Malin e pashkelë  
Mund ta terrojnë dhe perënditë  
e dot ta gjesh  
Itakën

*Këll, 1999*

# POETI ALI PODRIMJA

## 1. Poeti ndër poetët

Poezia e Ali Podrimjes është një masë për zhvillimet e poezisë shqipe në gjysmë shekullin e fundit, qoftë në nivel të konstanteve, qoftë në nivel të shndërrimeve. Kjo e provon identifikimin e poezisë së tij brenda poezisë shqipe, ashtu dhe identifikimin e poetit ndër poetët shqiptarë.

U takon poetëve të Kosovës, brezi i viteve '60 të shekullit XX, që poezinë nisin ta artikulojnë: si elegji intime, si revoltë sociale dhe si përkëndim të absolutit të përparimit.

Të gjithë këta poetë kishin pararendës të afërt Esad Mekulin e Martin Camajn, kurse paraardhës më të mëdhenj poetët shqiptarë të trashëgimisë lasgushiane e migjeniane, për të shkuar te trashëgimia poetike e rilindësve shqiptarë. Është brezi i poetëve që po shkolloheshin për letërsi. Aty ku flitet për grupin apo për rrethin poetik, domosdo flitet edhe për ngjashmëritë dhe dallimet. Përbashkësia krijon Frymën, ndërsa dallimet krijojnë individualitetet që vijnë duke u forcuar. Këto dallime ushqehen nga karaktere të veçanta, nga kultura të ndryshme letrare dhe në fillim e në fund nga talenti.

Ali Podrimja, më i riu në mesin e këtij brezi, shkëlqeu që në shfaqjen e parë me karakteristika që nuk do t'i lë kurrë, vetëm se duke theksuar ndonjëren prej tyre në faza të ndryshme të shkrimit poetik. Zëri i tij që në fillim u artikulua si *thirrje*, nocion zotërues

dhe karakterizues i shkrimit duke u bërë dhe titulli i vëllimit të tij të parë poetik. Thirrja e Ali Podrimjes tashmë nuk është invokacion me karakter figure, por karakteristikë e shkrimit demonstrativ, veprues, mënyrë e komunikimit të fuqishëm duke kërkuar dëgjuesin apo lexuesin si bashkëvuajtës në dhembje apo bashkëpjesëmarrës në ekzaltimin poetik. Ky komunikim poetik dramatik plot patos shenjon autorin si aktant të fuqishëm në jetën kulturore e sociale të vendit. Është koha kur zëri i poetëve dëgjohet shumë, duke i bërë ata të njohur jo vetëm në shoqërinë e leximit, por edhe në shoqërinë e kulturës. Në këtë mënyrë, krijuesi, me dashje apo pa dashje, bëhet veprimtar; ndërsa poezia, me dashje a pa dashje, bëhet edhe formë e veprimit; me mesazhe të qarta dhe me shprehje që kapen shpejt e mbahen mend.

Ali Podrimja, më i riu i brezit, kërkoi të jetë për herë i ri, jo vetëm në fushën e kërkimit, por edhe në fushën e bashkëjetesës gjysmë shekullore me brezin e vet dhe me brezat e rinj të poetëve të tjerë që do të shfaqen fuqishëm në vijim. Kështu ai ndërroi pamjen, por jo edhe esencën: në qenësinë e tij poetike mbeti *rebelimi* fillestar, qoftë në dramatikën e komunikimit me kohën e vet, qoftë në ngujimin (ishullimin), në dhembjen e vetvetes, qoftë në fluturimet poetike në kohë e në hapësirë, në gjeografi e në histori, nacionale apo universale. Mirëpo poezia e tij nuk iu largua asnjëherë një force të moralitetit, madje as atëherë kur krijohet nga elementet më intime, apo kur shtrihet në hapësirat e universalitetit. Malli për demonstrimin e moralitetit poetik nuk pushon as kur gjuha e poezisë është e shpallur, as kur kjo endet në labirintet e kërkimit hermetik.

Kjo është e pranishme edhe në librin “Torzo”, kur gjuha e poezisë bëhet figurë, e provokon sintaksën, bëhet shenjë, enigmë, elips, me trajta të sinkopave të mëdha, për të theksuar shkëlqimin e mungesave dhe kënaqësinë e kërkimit. Dhe kjo mund të shfaqet si një kërkim i poetit në fushën e hermetizmit.

Rishfaqja tjetër poetike e Ali Podrimjes merr trajtën e gjuhës kolokuiale me motivim ekstrem duke shpërthyer emocionet e forta të dhembjes e të pikëllimit. Mesa duket, kjo

është faza më e akseptueshme e poezisë së tij nga lexuesit shqiptarë. Dhe kjo ngjet për dy arsye: e para, Ali Podrimja këtu ka krijuar disa nga poezitë e tij më personale e më të njohura; e dyta, ngase lexuesi shqiptar deri më sot, më mirë e pranon poezinë e emocioneve të forta e të shpalimeve të drejtpërdrejta, sesa krijimin e kërkimin e thellë që futet në sferat e abstragimit poetik apo filozofik.

Dhe Podrimja, i rebelimeve dhe ndryshimeve poetike, nuk mund t'i shmangej kësaj, qoftë kur poetizon ndeshtrashat historike të shqiptarëve, qoftë kur reflekton e filozofon për natyrën e njeriut e të njerëzimit, duke përfshirë këtu edhe abstragimet e këngëve për jetën apo për shkrimet e vdekjes. Është mëse e qartë që në të gjitha ngushticat e jetës dhe të shpirtit shpëtimi mbetet dashuria, prandaj Podrimja, thellë në vete, mbetet poet i dashurisë për njeriun e jetën. Kjo, në anën tjetër, në mënyrë implicite tregon që urrejtja është ndryshkje e shpirtit, është sëmundje (në vështrimin elementar: *mos mundje*) që duhet të jetë sëmundja më e rëndë e sojit njerëzor. Jemi pra në fushën e humanistikës si fundament i veprës poetike të Ali Podrimjes që nga fillimet deri në fund.

## 2. Liriku i madh

Artisti është një vetmitar që lëviz në mesin e turmës. Ali Podrimja, si lirik i madh, flet me veten e me botën në nivel intimiteti, flet në vetën e parë të dramatizuar deri në teh. Për pasojë, ai komunikon me botën e kohën e vet, dhe kur ky komunikim nuk mjafton, krijon një botë paralele të cilën e rrijton sipas kriterëve dhe vlerave të veta, botë në të cilën sillet tërësisht i lirë, sillet si mbret. Ai e ka poezinë mënyrë të jetesës, të ekzistencës, e ka fe e atdhe, deri në përjetësi. Edhe kur bashkohet brenda me përjashtësi (Lasgushi); edhe kur rënkon për zemrën që bishat ia kanë ngrënë (Bodler); edhe kur shëtit me xhepa të shkyer e me kokë në yje (Rembo) ai është, demonstroi që është për të nënvizuar mitin prometean të qeniesimit e të qëndrësës.

Ky demonstrim duket dhe në shënime të vendeve dhe të datave kur dhe ku i shkruan poezitë, jo për të kapur frymëzimin e rastit e të çastit, po përkundrazi, për të ritheksuar grimcat e qenies e të kohës që përhumben në rruzullimin e tij poetik.

Ali Podrimja ka një relacion kaq specifik me poezinë përgjithësisht dhe me poezinë e vet. Do që poezia të mos jetë vetëm shkrim, po edhe zë i gjallë, bile muzikë e sferave të gjuhës. Ani që poezia e tij nuk bazohet në ritme të rregullta e në rimë, po më tepër në kokrrën e mendimit, ia ka ëndja që poezinë e vet ta thotë me zë të gjallë, duke theksuar zanoret, për ta kthyer atë në një si kantilenë. Gjë e vështirë, mundim i paparë: të kthehet në këngë zija e rëndë e mendimit. Po ku pyet poeti për të pamundurën? Prandaj ai shëtiti botën duke deklamuar poezinë e vet, thesarin e vet njerëzor, krijesën e vet si një ilaç të mbijetesës për të mundur harrimin.

Se, pat kënduar një pararendës i vet i madh, Zef Serembe: mall të pata më mallkove. Nuk i ka shpëtuar askush kësaj llahtarie të tmerrshme, nuk i shpëton dot as Ali Podrimja kur krijoi perlat e veta poetike që moti nuk janë të tijat, po trashëgimi për të tjerët.

### 3. Gjuha e poezisë

Ali Podrimja është poet, krijues. Poezia është forma e tij e vetme e shprehjes letrare, forma ideale e eksperimentimit e kërkimit gjuhësor, duke nisur nga fjalori, figura, forma, agramatikaliteti, provokimi i sintaksës. Më në fund: forma ideale e provës së gjuhës së motivueshme në nivelin sipëror. Kjo është formë në të cilën poeti provon gjuhën amtare, madje gjuhën e nënës, për të arritur në fund te idiolekti i tij. E idiolekti i tij është formë e elipsuar me denduri kuptimi, kurse poezia një formë e shkurtër dhe e përsosur.

Në varshmëri të plotë nga gjuha poetike është forma poetike e vjershës, duke ndjekur të gjitha fazat e shndërrimeve poetikës së Ali Podrimjes për një gjysmë shekulli.



Atëherë kur gjuha është shëmbëllim i rebelimit me fuqi të shpërthimit të thirrjes e të klithmës, vjersha merr trajtën e tregimit zanafillor, pa u lodhur tepër për disiplinën e vargnimit.

Atëherë kur shprehja bëhet simbolike, apo simboli vetë, forma e vjershës arrin kufirin e përsosjes formale që nuk duron variacione të rishkrimit.

Po kur gjuha zotërohet nga ironia e autoironia, vjersha shpeshherë merr trajtën e mbyllur të gjëgjëzës apo të enigmës, e cila kërkon zgjidhje dhe deshifrim nëpërmjet leximit të kujtueshëm.

Po kur shprehja merr ngjyrat natyrale e personale të pësimit, poezia ka trajtën e baladës klasike me variacione të baladës moderne.

Dhe kur gjuha e motivueshme personale thuret me mënyrat e kërkimit universal, atëherë forma e vjershës është tërësisht e lirë, duke hapur dilema të mëdha, duke shtruar pyetje të rënda të jetës, të vdekjes e të ekzistencës. Dhe duket që kjo është trajta më e lartë e poezisë së tij që mbetet të kërkohet në leximet e pritshme.

Përfundimisht: gjuha shpërthyesë e rebelimit, figura simbolike, shprehja e përmallimit, ironia e groteskut, figura e topikës, tirania e kohës, përpiqen të thuren të gjitha së bashku në një sistem të kujtesës (të sojit të Horhe Luis Borhesit) në temat historike shqiptare.

*Sabri Hamiti*



## PËRMBAJTJA

<b>NË BISHT TË SORRËS</b> .....	7
<b>VONË ÇEL DITA</b> .....	9
Loja me vdekjen .....	9
Nokturno.....	10
Në Planetin e Humbur.....	11
Krimineli në foto.....	12
Miu i shkurreve.....	13
Molla e Kuçe .....	14
Në mesnatë .....	15
Vajtojcat e Rekës .....	16
Sorrat.....	17
Pse më vritni zotëri.....	18
Njeriu që përshkroi rënien e diktaturës pa thënë një fjalë .	19
Gjaku i zi .....	21
Zgjimi i kobshëm i xhuxhimaxhuxhit.....	22
Meditim për zotin .....	23
Mos është njeriu .....	24
Në Kalvar .....	25
Vonë çel dita .....	26

UJI I MADH VJEN.....	27
Shikimi nga dritarja .....	27
Letër Petritit.....	28
Lament për Lirinë e njeriut.....	29
Këlthitje në shkretëtirë.....	30
Liria është e tmerrshme.....	31
Uji i madh vjen .....	33
Dhoma e bardhë suedeze.....	34
Në ekspozitë qensh.....	36
Midis xhunglës së betonit .....	37
PËRSE NUK MUND T’I MBYLL SYTË.....	38
Magjia e Kosovës .....	38
Gjarpri oh gjarpri .....	39
Atdheu është dhembje.....	40
Liria e tepërt.....	41
Fyshti i Fisit.....	42
Baladë për letrakun dhe Atdheun .....	43
Ngjitja në Majën e Tomorrit.....	44
Aletë e Korçës .....	45
Dinozaurët .....	46
Serbistani .....	47
Me qenë .....	49
Në mbarim të shekullit.....	50
Në mes butakëve.....	51
Shikoje terrin.....	52
Përse nuk mund t’i mbyll sytë .....	53
NË BISHT TË SORRËS.....	54
Fleta e mbramë e librit .....	54
Mbyllja e rrethit .....	55
Në bisht të sorrës .....	56

**BUZËQESHJE NË KAFAZ** .....57

Në një bodrum të shekullit njëzet .....59

**KËTU NË FUND TË BOTËS**.....60

Relike të fundshekullit.....60

Në hijen e zotit të padukshëm .....61

Promovimi i Satanës .....62

Qytetari i aparteidit .....64

Satana i sokaqeve të mia.....66

Evropa përmes grilave.....68

Delirium.....70

Prania ime athua tmerron .....71

Gjuha e qenit .....72

Rrënimi i përmendores së turpfit.....73

Në mes qirinjve .....74

Vajkënge.....76

Xhirimi i një filmi sekret .....77

Në teatrin e ri.....80

Fatet .....81

**KURDISE ORËN MEGJITHATË**.....82

Testamenti.....82

Ndjesë.....84

Dhjatë .....85

Poezia që nuk do ta kryej kurrë.....86

Përditshmëria ime .....87

Kjo ka ndodhur ndoshta para Krishtit .....88

Buzëqeshje në kafaz.....89

Himni i gazit .....90

Ato nuk janë varre .....91

Kur të prajnë.....92

Poesie forte .....93

Ora e gjimnastikës.....	94
Soditje mbi glob .....	96
Njerëzit e akullt .....	97
Kurdise orën megjithatë.....	99
<b>ATY KU NGRIN FLUTURIMI.....</b>	<b>100</b>
Lutjuni zotit tuaj.....	100
Histori qeni .....	101
Biri i bushtrës.....	102
Magnus .....	103
Robi i zotit .....	104
Perënditë dhe minjtë.....	105
Pastrimi shpirtëror .....	106
Dua të jetoj.....	107
Katrori magjik.....	108
Ç'vrasës më pret.....	109
Muri apo unë.....	110
Xhenazja.....	111
Shtëpia pa zot .....	112
Fundi i lojës.....	113
Nga fundi i një zezone .....	114
Gjumë të mirë e dashur.....	115
Do t'i them të njëjtat fjalë .....	116
Libri i pakryer .....	118
Unë do të kisha atdhe.....	119
Para se ta fik llambën.....	120
Udhëtimi me ujë .....	121
Lexuesit e vdekur .....	122
Guaska .....	123
Atdheu i mbërthyer në arkë.....	124
Në shtëpinë e Martin Camajt .....	126
Takim me zotin e harruar .....	127
Anija e bardhë.....	128

<b>KUR U ZGJUAM</b> .....	129
Plagë e gjallë.....	129
Shqiptarët .....	130
Ose, ose .....	131
Në zgripç.....	132
Klithje në shpellë.....	133
Një ditë tepër shumë .....	134
Në zindane .....	135
Dëshmi .....	136
Elegji .....	137
Yrnek i keq.....	138
Golfi.....	139
Pasaniku e ka qenin.....	140
Fotografia jonë ose etnia.....	141
Këmisha ime .....	142
Përshëndetjet e fundit.....	144
Orë nga etika.....	145
Salzburgu në shi .....	146
Liria është e tmerrshme.....	147
Nuk jam vetëm .....	148
Varri nën ullinj.....	149
Kur u zgjuam .....	151

**ISHULLI ALBANIA** .....153

Shenja.....	155
-------------	-----

**ISHULLI ALBANIA** .....156

Korbi.....	156
Pasqyra e thyer.....	157
Negativi i fotografisë .....	159
Krijesë e verdhë.....	160
Kulla e Balshajve.....	161

Dritarja e hapur .....	162
Përmbytja e re.....	163
Mbreti i vendit të vogël .....	164
Kuajt e coftë .....	165
Sheshet e zbrazëta të Evropës.....	166
Shtëpitë publike të Ballkanit.....	167
Llava.....	168
Vdekja e njeriut apo e Ullirit .....	169
Ishulli Albania.....	170
Etydë për Shqipërinë .....	171
A do ta shoh Shkodrën .....	172
Beteja e Kosovës.....	173
Apo.....	174
<b>REVOLTA E ROKERIT TË DHEUT TË SHQIPEVE .....</b>	<b>175</b>
Djaloshi në këmishë të Gostivarit .....	175
Snajperët.....	178
Pazari i vdekur .....	179
Engjëlli i Zi i Sarajevës .....	180
Shoferët e mortit .....	181
Morbiditeti .....	182
Mjerimi njerëzor.....	183
Apatritët.....	184
Perëndimi i këngës .....	185
Ngjitja në Majë .....	186
Vaji për të zonë .....	187
Revolta e rokerit të Dheut të Shqipeve.....	189
Lufta në mënyrën habitore .....	192
<b>MALI I MISTERSHËM .....</b>	<b>193</b>
Grigja .....	193
Tatëpjetë Golgotës.....	194
Famë e qyqes .....	195
Troku mortar .....	196
Maja e humbur .....	197



Humbja në oborr .....	198
Në fillim të lojës .....	199
Mali i mistershëm .....	200
Pika e bardhë .....	201
Vdekja .....	202
<b>HAPJA E NJË POEZIE NË KOHË TRISHTIMI .....</b>	<b>203</b>
Rinjohja.....	203
Baladë për dashnorin e madh.....	204
Nuk ka gjë pa diç të saj.....	205
Shpirti i humbur .....	207
Hapja e një poezie në kohë trishtimi.....	208
Ëndërrimtarët .....	209
Hana.....	210
Odë hyjnie.....	211
<b>ATY KU NUK ËSHTË MË.....</b>	<b>212</b>
Zot a më sheh kund.....	212
Dinosauri modern.....	213
Bostadel.....	214
Vaji i një shqiptareje që e shënova diku në Evropë .....	215
Aty ku nuk është më.....	216
Zoti i lakuriqar.....	217
Gri.....	218
Arti i vdekjes.....	219
<b>PIKË E ZEZË NË BLU .....</b>	<b>221</b>
Biblike.....	223
<b>IMAZH I AKULLT.....</b>	<b>224</b>
Një i vdekur i zakonshëm .....	224
Gjysmëfotografia.....	225

Lëkurë për një dauille .....	226
Hija e kodit të maleve.....	227
Nëna zbret në zemër të dheut.....	228
Orë e Tynzot.....	229
Zgjimi.....	230
Karasinanpasha.....	232
Eklipsi .....	233
Drenica .....	234
Litari i ankthit .....	236
Shqipëritë.....	237
Hiri i shkëlqimit.....	238
Libri i pakryer .....	239
MARATONI NGA ILIRIA .....	240
23 Shkurti .....	240
Liqeni në maje .....	241
Në xhamin e errët imazh i së nesërmes .....	242
Nuk zgjohet Dranja e Martinit.....	243
Baladë.....	245
Fëmijët e vdekjes.....	246
Fusha e zezë.....	247
Tek pikasja ngjyrën time .....	248
Maratoni nga Iliria.....	249
MES UJIT TË MADH DHE ËNDRRËS.....	250
Ulciniumi.....	250
Pushtimi i fundit i Labeatëve.....	251
Vorbulla.....	252
Thika .....	254
Varrezat e kaltra .....	255
Imazh pikëllues.....	256
Muri i padukshëm .....	257
Do vijë koha ime po s’do jem unë.....	258
Lehje atje poshtë .....	259
Mërzia e dheut .....	260

PIKË E ZEZË NË BLU .....	261
Palaçoja.....	261
Trok i azdisur.....	263
Kohë e të qeshurit.....	264
Bastardi.....	265
I marri i sokaqeve tona.....	266
Pikë e zezë në blu.....	268
Kur sheh ëndërr qeni.....	269
Përmendorja e viçit.....	270
Zerot .....	272
BREGU JA ERRET .....	273
Universi i pikës .....	273
Shket një liburnë.....	274
Në mbretërinë blu.....	276
Dritë e brendshme .....	277
Cunami nën çarçaf.....	279
Përflakja e trupave.....	280
Zoti nuk është mace .....	281
Bregu ja erret.....	282
Të buzëqesh mortja ime.....	283
Udhëtimi nëpër pyll.....	284
POETI ALI PODRIMJA.....	285

ALI PODRIMJA

# VEPRA

Vëllimi i pestë

Prishtinë, 2013

Botues:

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS

Design: ZENI BALLAZHI

Radhitja & faqësja: BURIM REXHEPI

Lektor & korrektor: SHEFQET RIZA

Madhësia: 18.75 tabakë shtypi

Tirazhi: 500 kopje

Formati A5 (14.8 x 21 cm)

Shtypi: FOCUS-PRINT, Prishtinë-Shkup

Katalogimi në botim – (CIP)

Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

821.18-1

Podrimja, Ali

Vepra = Works / Ali Podrimja. - Prishtina : Akademia e Shkencave dhe Arteve e Kosovës : Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, 2013. - libra ; 21cm.

Vëllimi 5 : Në bishtë të sorrës ; Pikë e zezë në blu. – 300 f.,  
portreti i autorit

Poeti Ali Podrimja / Sabri Hamiti : f. 285-289

**ISBN 978-9951-615-14-3**

**ISBN 978-9951-615-19-8**